





Zëri i Kosovës krahi i fuqishëm i luftës së popullit tonë dhe lëvizjes atdhetare të Kosovës

# ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës

dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi



Nr. 1 Nëntor 1981

## Kosova gjëmëmadhe, trimëresha Kosovë

Ditët, javët e muajt po kalojnë mbi tragjedinë tënde me të re, Kosovë, si mbi trupin e mpirë të një të njohuri në vjetër, të cilit s'iu nda në shënjë gjëma e madhe e robërisë, por as kënga e të pamposhturit s'iu shua mbi buzët e çara, të çara për lëngun e shëndetsbëm të lirisë.

Në pragun e stinës së përtëritjes, Kosova jonë martire, ti u godite nga acari i egër, që po kanoset të t'i thajë rrembat e gjakut, të ta zërrë frymën, të të ngurojë me gjithë çka ke.

Hordbi të shumta barbare serbe u dnyndën me çelik e barot drejt teje në euforinë e tyre fashiste. Si tibe gla u derdhën nëpër rrugët e qyteteve dhe fshatrave të tua. Qielli yt u err nga aeroplanët, helikopterët e gazet lotshjellëse. Toka jote, që sapo e kishte shkëmbur trupin e saj të bështet në t'u dhënë farës së jetës, u drodh nën zinxhirët e tankeve, nën pesbën e autoblinadave. Mbi të u bodh fara e vdekjes. Piu mbat e mitralozit shtrinë përdhë fëmijën, plakun, gruan shtatëdhë dhe djalin e vajzën shqiptare, lulekuqen tënde.

Për të tretën herë gjatë motit të egër tuit, Kosova jonë me balë, për bukën dhe të drejtat që kërkove nga dëshpërimi i shtrinë, more përgjigjen me plumb dhe u ul në gjakun e bijve të tu të pafajshëm, duartbatë.

Dhe tash, Kosovë, ç'të të qaj me parë, unë, biri yt revolucionar? Të qaj të kaluarën tënde helm apo



Xhamadanin e trimërisë, të veshur nga Mic Sokoli, Selam Labi e Vojo Kushi, e pa serbomadh të veshur kësaj pranverë nga djalinë kosovare

të tashmen tënde pelim? Netët që err apo ditët që gdhin me këmbën e të huajit brenda! Të të qaj bukën që s'iu dha. Ti gjithmonë pate sofrë bujare për të tjerët edhe kur s'kishte bukë për vete. Tani ta kanë zënë derën, ta zbrazin magjen e t'i hedhin me përduaje mysat e bukës, që ke gatuar me duart e tua. Bëjnë ligjin në shtëpinë tënde dhe presin prej teje që ti të përkulesh e të marrësh si lëmoshë frytin e djersës dhe të pasurisë sate. Për bukë të të ankoj, pranë sofrës e pangrëna Kosovë?!

Të drejtat që t'u shkëlën, ato të t'i qaj? Ti rrite me mundimë djemët, jetimat e tu, hoqe për ta kafshatën nga goja, tesbën nga trupi. Isb-

te e drejtë që ata të të shpërblenin një ditë. Dhe u çuan e dolën rrugëve e shesheve të tua: «Dua bukë!», — thirrën me sa zë patën, — «Dua bukën tonë, jo mëshirën e buaj, drejtësi dua, me mjaft kemi mbetur rrugëve të botës të treckosur e të dregëzuar, të dërmuar urie e skamjeje, postërimi e përduajeje. Dua ta gëzojmë emrin tonë të vërtetë, që na u mobua me dhu-në!»

Apo varret e reja të t'i qaj, Kosova gjëmëmadhe? Të kërkosh bukë, bukën tënde, paska qenë «krim!» Në vend që ti të hapje magjen, ba pe bringat e tokës sate dhe ua bëre varrin djemve të tu. Pikëllimi i pamatë duhet të jetë pikëllimi yt,

Kosova jonë martire, Lëre që t'i shtrinë përdhë djemët e dëshurit, bonjakët e tu, po as gjëmën s'te lamë t'ua bësht. Të të shkojnë djemët pa nam e nisban?!

Ndoshta plagët në trupin e ri e të bështet në djalërisë sate, Kosovë, ato duhet të t'i qaj? Ku i ke spitale, ku i ke mjekët që i ngrite me thonjtë e duarve? Për kë ndërtove e për kë u mundove? Që, kur t'u duben më së shumti djemve të tu, për të mjekuar plagët që morën duke kërkuar për ty bukë e të drejta, ti të mos i shtrinë në spitale, po ata të mjekohen shpëllave me barishte, ose djerve të botës, si harbutë?! Apo i ke për të mjekuar milicët dhe ushtarët e buaj, xbrilatët e djemve të tu! Ata, moj nënë-loke, erdhën të të bapin plagë dhe të t'i hedhin edhe një herë trupit pranga të reja.

Të të qaj burgun e zif Ishte e drejtë që burgjet t'i mbaje për kriminelë e kopukë. Pse i mbsube djemte e tu më të mirë? Si s'pelasin të shkreretat, gjithë ajo rini që dergjet në to!

Të të qaj Universitetin që mban emrin tënd? Na e mbyllën urtakun tonë të shtrënjtë, në mosbe të mitur, dymbëdhjetë vjeçe më! Sa kishte nisur t'ua ndrinte mendjen bijve e bijave të tua, t'i nxirrte ata nga sketerra ku i kanë katandisur ata që sot barboben me uniforma rrugëve të tua, me këllefet e revoleve zhveshur, me automatikët në duar, me ngërdëshjen e shfrenuar në buzë, me vullën e krimin e të turpit në shpirt. Të të qaj shkollat, ku s' do të ketë më vend për filizat e tua! Çfarë bimësh të pajfruta do të shartojnë tash mbi filizat, zona, lokja jonë dritëpaka! Asosh që do të të nxjerrin sytë kur ty të dubet drita, që do të të guajnë me gurë kur ty të dubet buka, atosh që, duke u përjargur, me gjuhën e ntrasur të të çkombëtarizuarit, do ta këndojnë këngën e të huajit e cila t'i çon pesbë plagët. Këngën që flet me epsh për shtratin tënd të shkrur, për sofrën tënde të përmbysur, për shkëlmat, plagët e postërimet që të dhanë.

Të të qaj Naimin, Çajupin, Asdrenin? Ligjërmi i tyre i lirisë u dasbka t'ia lëshojë radhën në ligjërmi tjetër, atij të robërisë. U dasbka që pjella jote e brishtë ta shplajë

# Sejdi GEGA

Botues:

SHOQATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE



Këshilli redaktues:

Fazli Veliu, Sejdi Gega, Ekrem Ajruli

Këtë libër ia kushtojmë themeluesit dhe **prijësit** të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare - **Adem Dema (Demaçi)**, së bashku me gjeneratën e Tij dhe ato pasuese të **përkushtimit** për LIRI-BASHKIM-FLAMUR KOMBËTAR



***Lëvizja Popullore e Kosovës, riorganizoi disa herë radhët, riarmatosi bijtë dhe bijat e popullit me dije dhe pushkët e lirisë, duke i kalitur këto gjenerata për beteja... të njëpasnjëshme, përfundimisht në shkallën kombëtare: Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, UÇPMB dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare.***

**LAVDI! F. Veliu**

Shtypi:  
**Arbëria** Design  
www.arberladesign.com.mk

## ZËRI I KOSOVËS – ZËRI I POPULLIT TONË PËR LIRI E BASHKIM KOMBËTAR

Zëri i Kosovës, që nga fillimi kur doli së bashku me revoltën e përgjithshme të studentëve, punëtorëve e fshatarëve kundër regjimit diskriminues të Beogradit, u bë tribunë e fuqishme e popullit të Kosovës.

Emri kuptimplotë, që sublimoi një popull të ndarë e të robëruar, i cili në të gjitha kohët bëri përpjekje të pandalshme për t'u çliruar dhe bashkuar me mbarë kombin shqiptar, i mbeti besnik atij, barti mesazhet e bijve dhe bijave më të përkushtuara-deri në ditët e sotme, kur po bëhet realitet përpjekja e përbashkët për të hequr prangat dhe zgjedhën sllave. Shkrimet e „Zërit të Kosovës“ nuk ishin të rëndomta e të një rrjedhe të njëjtë si të gazetave të atëhershme e të mëvonshme legale. Ishin shënimet e të burgosurve shqiptarë që shkruheshin me duar të përgjakura nga gardianët e policët, udbashët dhe spiunët, tradhtarët e karrieristët. Ishin edhe shënimet e studentëve të përjashtuar nga procesi arsimor, mbasi kishin qenë të pandarë nga masat e gjera të popullit të shumëvuajtur. Ishin edhe shënimet e mërgimtarëve të shumtë, të ndjekur dhe të emëruar si të padëshirueshëm për regjimin dhe përkrahësit e tij shqiptarë.

Zërin e Kosovës e nxorën në dritë bijtë dhe bijat që patën mesazhin e madh të popullit të Kosovës: ndërgjegjësimin për çlirim dhe bashkim, jehonën e kushtimit brenda dhe jashtë. Jashtë vendit Zërin e Kosovës e përgatiti dhe shpërndau Jusuf Gërvalla me gjeneratën e betuar, ndërsa brenda vendit e ngritën dhe vulosën me gjakun e pastër Rexhep Mala në burgje me shumë të burgosur, Nuhi Berisha me të mërguarit dhe të mbeturit udhëkryqeve të Ballkanit. Afrim Zhitia me gjeneratën e ndërgjegjes së rëndë e të lartësuar për të vazhduar veprimtarinë kombëtare.

Zëri i Kosovës arriti të bëhet zëri i shqiptarëve në mbarë viset shqiptare të sunduara nga pushtuesit sllavë. Si i tillë ai depërtoi thellë në zemrën e çdo shqiptari, në viset ku flitej dhe shkruhej shqip. Prandaj, Zëri i Kosovës u bë një dell gjaku që arrinte te zemra e madhe e kombit dhe Atdheut. Në faqet e Zërit të Kosovës, që nga fillimi i luftës për liri, të motivuar, iniciuar dhe nisur nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, gjetën vendin dhe përkrahjen e pakursyer luftëtarët e lirisë, bijtë dhe bijat e Kosovës martire, të vendosur në rrugën e vështirë por të vetme të çlirimit dhe bashkimit, me ribetimin: Liri a Vdekje.

Zëri i Kosovës nuk shfaqti dhe mbrojti në asnjë kohë vetëm anëtarësinë e tij dhe të organizatës së cilës i takonte dhe i takon- LPK-së, por mbarë çështjen kombëtare, mbasi edhe programin e pati dhe e ka të tillë, mbasi vetë populli i Kosovës është pjesë e pandalshme e kombit shqiptar. Zëri i Kosovës, duke hapëruar me kohën, del ditor.

Ai bart mesazhet e të parëve dhe përpjekjet e të gjithëve, brenda dhe jashtë, shtytjen e luftës dhe çështjes në lartësinë që e meriton populli i pamposhtur i Kosovës, në shkallën që kthen dinjitetin tonë kombëtar.

Vite të tëra denoncuam politikën në të gjitha meridianët, e cila përsëritë diplomacitë e fshehta e të hapura kundër nesh. Kaq vite kërkojmë nga ndërgjegjja e vrarë e Evropës

që të korrigjojë gabimet dhe të na trajtojë siç jemi-një komb me autoktoni të dëshmuar në shekuj. Po kaq vite kërkujmë që të dënohen vrasësit e të gjithë bijve e bijave të popullit të Kosovës.

Betimit të madh në Kosovë iu përgjigjën shokë të të njëjtit ideal. Po në janar, dy vite pas, Rexhep Malaj dhe Nuhi Berisha sfiduan njësitë policore e ushtarake jugosllave. Këta bij të Kosovës, të dhënë për çështjen e atdheut që në rini, pasi kryen veprimtari të dendur brenda dhe jashtë, bënë përgatitjet e para të kundërvënies me mjete vetëmbrojtjeje dhe mbrojtje. Rexhepi, mbasi shkroi me gjakun e tij e të shokëve ditarin në burgjet fashiste sllave, mbasi e kishte ndihmuar daljen e Zërit të Kosovës dhe kishte këmbëngulë që të qëndrojnë në Kosovë, i ndjekur gjithmonë, nuk e la pa kryer betimin e dhënë.

Armiqve e tradhtarëve iu përgjigjet me zjarr e flakë. Pranë tij, Nuhi Berisha, veprimtari ynë edhe jashtë vendit, që më parë shkroi veprën për mënyrën e organizimit, si dhe atë të ngjarjeve të vitit 1981-„Pranverë e luleve të kuqe“, bashkoi armën kundër barbarëve sllavë.

Vitet që pasuan nuk qenë pa përpjekje dhe pa mund e sakrificë për çlirimin e viseve tona. Në radhën e luftëtarëve të lirisë u radhitën Bajram Bahtiri, Ali Ajeti, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Tahir Lush Berisha, Hasan Ramadani, Besim Ndrecaj e shumë të tjerë. Ajo vepër e bërë nga veprimtarët e pandalshëm, frymëzoi studentë, punëtorë e fshatarë etj. Dhe nuk ishte vetëm krijimtaria letrare e nisur në Shkup e Prishtinë. Jusuf Gërvalla përveç krijimtarisë së gjerë, bëri edhe atë të organizimit, të konsolidimit dhe përgatitjes së radhëve për çlirimin dhe bashkimin e viseve shqiptare në Jugosllavi.

Pena e Tij, e Kadri Zekës, e të gjithë veprimtarëve të kohës së Tyre ndryshonte krejtësisht, nga ato që shkruanin brenda vendit (të cilët ishin nën ndikimin e jetës së vëllazërim –bashkimit, që krijonin himne për satrapin Tito dhe bashkëpunëtorët e tij)...

Pas një hulumtimi të thellë shkencor e atdhetar, këtë verë përmbillet punimi i shumëpritur për ecurinë e Zërit të Kosovës nga bashkëveprimtari i çështjes sonë – **Sejdi Gega**. Ideja për të kryer, nga afër, me përkushtim, këtë detyrë fisnike: Autori – të mbijetuarit e Zërit të Kosovës dhe Lëvizjes Popullore të Kosovës, si dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u realizua.

Në fillim kjo detyrë dukej shumë e vështirë. Ku, kur, si – të nisej shkrimi ?!

Autori zgjodhi – fillimin – administratën, shënimet ; kudo që ishin, pjesë – pjesë mandej edhe ekzemplarët e plotë, i radhiti në fletoren e punës, në kompjuter.

Ne që ishim hartues të shumë punimeve, rrudhnm krahët, në shenjë pëlqimi e miratimi, me drojën se një veprim i tillë, mund të mbetet në gjysmë të rrugës (nëse nuk i afronim të gjitha kushtet).

Duke e ditur këmbëngulësinë e Tij, ne i dëshiruam suksese në këtë fushë të pa grumbulluar e të pasistemuar...

Siç shihet, motivimi kryesor, i Atij dhe veprimtarëve, të cilët, me Zërin e Kosovës, në anën e zemrës, përfunduan nën torturat e gardianëve në burgje, policëve në rrugë,

shkolla..., po lartësohej. Zëri i prindërve për bijtë dhe bijat e Tyre, që ranë duke shpërndarë zërin jehues, sikur u lartësua me lavdinë, krenarinë...

Zëri i Nënë Ajshes, dëgjohej e shkruhej

Zëri i Nënë Hanes, e cila qante më shumë për Kosovën sesa për djalin e Saj.

Zëri i bijës së Rexhep Malës: Fitores, për babanë- Dëshmor të Atdheut

Zëri i prindërve të Luftëtarëve të tri Emblemave të UÇK-së...

Punimi do të bartë – dengjet e fletëve të shumta të shtypit tonë ndër dekada, përmes – Zërit të Kosovës e botimeve të tij...

Gjeneratat e Përkushtimit të madh, përjetuan tmerret e burgjeve fashiste jugosllave, ndjekjet e pandërprera, brenda dhe jashtë vendit. Sa herë që pushtuesit i duhej një shkas për të marrë masa shtrënguese ndaj popullit tonë të pambrojtur, të parët që i ndëshkonte ishin bijtë dhe bijat e revolucionit, Rilindjes Kombëtare, përkrahësit e masave të gjëra. Mbi ata dhe ato, vërsuleshin xhelatët, gardianët, UDB-ashët, mashat e tyre. Por, çdoherë të betuarit në Atdhe, Komb e Flamur shqiptar, ngjiteshin ngadhënjyes, të pamposhtur, fitues. Me plagë në shpirt, zemër, trup, ecnin drejt shtigjeve të lirisë, dritës, ardhmërisë...

Njeri nga Ata, Sejdi Gega na doli i pagjunjësuar nga burgjet dhe iu bashkëngjiti veprimtarisë sonë në mërgim: Ishte shëndetlig, i dërrmuar por i gatshëm për të marrë detyrë në kuadër të Lëvizjes sonë, të cilën, ne të mërguarit, e bartnim si trashëgim – thesar, nga i burgosuri i dekadave – Adem Demaçi, nga korifenjtë e Lëvizjes: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla e shumë të tjerë, të rënë e në këmbë...

Ai, në mesin tonë vinte me kujtimet e pashlyeshme për të burgosurit. Për ata, ai fliste me adhurim dhe besim, duke na sjellë edhe portretet e tyre, të krijuara në burgjet e hekurta jugosllave. Kur hyri në mesin tonë, kërkoi t i caktonim detyra më të vështira dhe më të rëndësishme. Nga shtator/tetori i viti 1991 do të kalojë jetë ilegale deri në fillim të janarit 1992, kur detyrohet të lëshojë Kosovën.

Nga janari i vitit 1992 do të bëjë jetë mërgimtari në Zvicër. Tri vitet e para do të punojë mësues, në mësimin plotësues me nxënësit shqiptarë në Kanton Uri.

Anëtar aktiv i LPK-së, Dega jashtë vendit, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm deri në mbarim të luftës, anëtar i Kryesisë së Nëndegës së LPK-së për Zvicër, me përgjegjësin e arkëtarit. Nga korriku i vitit 1998, anëtar i Kryesisë së LPK-së, me përgjegjësinë e Përgjegjësit Financiar për Degën e LPK-së jashtë vendit.

Sejdi Gega, personalisht dhe me anëtarët e familjes së tij të ngushtë, si dhe me veprimtarët e përkushtimit të Madh Kombëtar, krijoi kushte veprimtarie, të cilat ishin në vazhden e pararendësve të betuar në Atdhe, Komb, Flamur.

Një kujdes të veçantë, dëshmoi ndaj kryepersonazhit të lëvizjes Adem Demaçi, bashkëveprimtarit të këtij Ahmet Haxhiu, drejtpërdrejt ndaj Fadil Vatës, Ukshin Hotit, Beadin Hallaçit etj. Aktualisht është në lidhje të ngushtë me frymëzuesin kryesor të të gjitha gjeneratave- Adem Demën dhe familjen e tij të ngushtë.

*Urime! Motivime të reja!*

*Fazil Veliu-Korrik, 2016, Lucern (CH).*

## VAZHDUESI I LUFTËS PËR BASHKIM KOMBËTAR



Shaban Polluzha

## MARTIRËT E KOSOVËS - FLAMURIT KOMBËTAR



Adem Demaçi  
1936



Metush Krasniqi  
1928 - 1986



Fazli Grajçevci  
1936-1964

## YJET E KOSOVËS - NDRIÇUES TË RRUGËS SONË DREJT LIRISË



Jusuf Gërvalla



Kadri Zeka



Bardhosh Gërvalla 1946-1982  
1953-1982 1951-1982

## LUFTËTARË TË LIRISË - DËSHMORË TË ATDHEUT



Rexhep Malaj  
1951-1984



Nuhi Berisha  
1961-1984



Bajram Bahtiri  
1961-1984



Zija Shemsiut  
1950 - 1985





*Murat Mehmeti dëshmor i qëndresës (nxënës i gjimnazit të Prishtinës)*



**Mehmetriza-Murtezani- Gega**  
1921-2006  
Veprimtar i qëndresës dhe i  
bashkimit të trojeve shqiptare.



**Rafi Halili:**  
Shëmbëllyes i përbetuar për Atdhe

## PARALAJMËRUESIT E USHTRISË ÇLIRIMTARE




*Tre viganët: Fadil Vata, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu*

Në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, Kosovës së pushtuar nga Jugosllavia e Titos dhe ndarjes së saj midis Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, ndër të drejtat të cinguara shqiptarëve iu lejua gazeta në gjuhën shqipe, po që i shërbente fund e krye politikës antishqiptare që ndiqte regjimi i Titos. Meqë në këtë gazetë nuk lejohej të shkruhej e të botohej asnjë rresht, që mund të binte në kundërshtim me politikën e Titos, pra, të „Bashkim – Vëllazërimit“, atdhetarët e Kosovës ishin të detyruar të shkruanin dhe shumëzonin trakte, pamflete, parulla dhe fletushka, që shpërndaheshin fshehurazi nga pushtuesit.

Embrioni i gazetës „Zëri i Kosovës“, daton qysh në pranverën e vitit 1974, kur Kadri Osmani, Kadri Zeka, Rexhep Mala e Xhaferr Shatri me shokë, në bodrumin e lagët të shtëpisë së Kadri Osmanit në Prishtinë nisën ta nxjerrin organin e „Grupit Revolucionar“ (më vonë Organizata Marksiste – Leniniste e Kosovës), Si çdo fillim që kërkonte sakrificë përkatëse, edhe Zëri pati dhembjet e lindjes, por ai ia doli, doli i kuq dhe kështu nisën themelet e publicistikës ilegale kosovare nën peshën e rëndë të sundimit serbomadhe e të terrorit të UDB-ës.

Ani se teknikisht jo mirë i përgatitur, megjithatë përmbajtja e tij, ngjyrë e barot e përzier, nisi të pushtoi lexues anë e kënd Kosovës; simboli i tij, dielli në të lindur, nisi të lëshojë rrezet e veta të para në Universitetin e Prishtinës. Shumë studentë u mblodhën rreth tij dhe provuan dridhjet e para me penë në dorë. Kanë nxjerr dy numra të parë të fletushkës „Zëri i Kosovës“.

Në shtëpinë e Kadri Osmanit, në dhomën e fjetjes së Kadriut ishte ndërtuar një bunker Bodrum për t i fshehur shaptilografin dhe makinën e shkrimit dhe për të shtypur revistën e pamflete të ndryshme.



Dokumente nga arkivi i sigurimit shtetëror që i kanë ruajtur makinat e shtypit të marra në shtëpinë e Kadriut gjatë bastisjes, kështu deklaron vajza e Kadriut-Hidajeti.



Në kohën kur për shkaqe konspiracioni u pa e arsyeshme që Zëri të dalë në emër tjetër, me emrin „Liria“ dhe në vitin 1976, fillojnë të botohen edhe revistat tjera ilegale si; „Lajmëtari i Lirisë“, „Bashkimi“, „Punëtori“, që frymëzohin rininë e popullit shqiptar për betejat e radhës, drejt realizimit të Republikës së Kosovës dhe bashkimit kombëtar, u mundësua strategjia e Zërit të Kosovës, në dekada. Zëri i Kosovës megjithatë nuk heshti; shok lufte e ideali, djem petrita si Jusuf Gervalla vendosën ta nxjerrin sërish Zërin.

Me fuqizimin e Lëvizjes së fshehtë, me daljen në shtetet perëndimore të disa atdhetarëve të rrezikuar nga policia e fshehtë jugosllave, sidomos pas arrestimit të grupit: **Isa Demaj, Avdi Kelmendi, Avdyl Lahu, Hysen Gërvalla, Skënder Jashari, Ramadan Pllana**, në dhjetor të vitit 1979, Jusuf Gërvalla ishte detyruar të arratisë në perëndim ku dhe fillon edhe botimi i disa gazetave dhe revistave atdhetare, u fuqizuar krijimtaria revolucionare, drejtuese e veprimtarëve.



Mbi bazën e përvojave më të mira të këtyre revistave, rilindi „Zëri i Kosovës“, në nëntor të viti 1981 nga njeriu i artit dhe i letrave, patrioti martir, pra tash Hero i Kosovës – Jusuf Gërvalla. Ai do ta rinxjerrë sërish fletushkën, gazetën emër-mirë „Zëri i Kosovës“, e cila vazhdoi t i kalojë sfidat e kohës në rrugëtimin e sajë duke u bërë përçuesja më besnike e zërit të Adem Demaçit, Kosovës dhe e zërit të shqiptarëve të pushtuar. Pra, në vitin 1981, kur në Kosovë kishte flakë e zjarr, doli i përtërirë e jehues Zëri i Kosovës. Në ballë të tij tashmë qëndronte një luftëtar lirie, i cili me mallin për vllimtar të mërgimtarit, shkriu ndjenjat e tij, derdhi talentin e tij të papërsëritshëm duke i dhënë Zërit jehonën e emrit që kishte, e cila vazhdoi t i kalojë sfidat e kohës në rrugëtimin e saj, duke u bërë përçuesja më besnike e zërit të Adem Demaçit, Kosovës dhe e zërit të shqiptarëve të pushtuar.

Numrin e fundit e shkroi me gjakun e vet. Ai ra, ra për të mos vdekur redaktori i famshëm i Zërit të Kosovës, por Zëri prapë, si Feniksi, lindi, vazhdojë të jetojë, vazhdojë të qajë dhembjet e popullit dhe lëshojë kushttrimin e tij, tashmë si organ i të gjitha organizatave patriotike që kishin luftuar e ishin përleshur me pushtuesit jugosllav.

## Jusuf Gërvalla, daljen e Zërit të Kosovës do ta arsyetojë si vijon:

### TE DASHUR LEXUES,

Kemi ndërr, detyrën dhe përgjegjësinë e madhe të dalim para jush me revistën periudike «Zëri i Kosovës» \* pikërisht në një çast historik, kur në ndërgjegjen e popullit dhe të rinisë sonë bërke po trokasin fuqishëm pulset e lirisë që po agon. Sot për sot, në trupin e këtij populli dhe të kësaj rime po vizatohen qartë projektionet e plagëve të reja që do të merren, por njëherazi po bëhen edhe themelet e çelikut të ardhmërisë së sigurt e të ndritshme.

E sëmurë e Ballkanit, Jugosllavia, këmba këmbës po i afrohet shtrati të një vdekjeje të turpshme. Ekonomia e saj, e bazuar në pjesën më të madhe mbi ndihmat dhe mbi kapitalin e huaj, po gremiset nga minuta në minutë. Standardi jetësor ka rënë aq poshtë, sa vetëm që s'kanë kumbuar kambanat e falimentimit të plotë. Dinari është zbulerësuar dhe është bërë si një paçavure qerepi, kurse inflacioni s'është ndalur. Dhe sa më shumë që thellohet kriza, aq më shumë vete e nxiton hapin anarkia në treg, e të mos flasim për çmimet; qeveria e Beogradit nuk po gjen dot fren për t'ia ndalur turmin kalit të bas-ditur të çmimeve, i cili po e ba dëgjinin si i flamosur.

Të tillët, sig' është e natyrishe për ta, po bëjnë komo për t'i mbuluar shkaqet e vërteta të gjendjes kaq të mjeruar. Përpjekjet më të dëshpëruara ata i bëjnë sidomos për të mbuluar dometbënie dhe shkallën e vërtetë të krizës, që s'është tjetër pos nisma e zëshme e bankruitit të turpshëm e të plotë të «vetëadministrimit» jugosllav.

Kompensimin për fatkeqësitë, shkaktarë të të cilëve janë vetë me begjemonizimin e tyre, serbomë-dhënie kanë ndarë mendjen ta nxjerrin në shtypjen e përgjaksme të kërkesave të ligjsbme të popullit shqiptar në Jugosllavi. Për demonstratave të rinisë dhe të popullit tonë u tregua sa aterië e të pa-gëndrueshme ishin demagogjitë 40-jeqare të titistëve për barazinë dhe vëllazërim-bashkimin e popujve, ato ncoerën në pab fytoren e gëlbmonsime të shovinizmit serbomadh, i cili ndër shëkuj s'ka lënë gjë pa bërë dhe aleat pa shfrytësuar vetëm e vetëm për të mbytur që në zanafillë çdo përpjekje të shqiptarëve për autonominë, moestësi e pavarësi. Doleën shësbet inkonsideratat e njohura të shovinizmit serbomadh ndaj jetës së njerëzve, ndaj historisë, kulturës dhe traditës së popujve të tjerë, veçmas të shqiptarëve.

Ata pandehin se me një goditje të rrufeshme policore e ushtarake, me «diferencimet» e tyre të dëbunsime, do ta gujëzëpjnë popullin dhe rininë tonë trime, ta shtyjnë atë që të beqë dorë jo vetëm nga kërkësat e shtruar në mars e prill, por edhe nga ato pak të drejta formale të mëparshme, të fituara me gjakun e derdhur. Ata do të kishin dasbur të na katandisnin edhe një herë në gremërinë rauh-kouçiane e më zi. Por, përgjigjen për këtë po e marrin dita me ditë nga pasardhësit e Skënderit e të Abdyllit, të Buletinit e Jutrit Selërit, të shovinizmit e shovinizmit të mos përulen jo vetëm përpara torturave shtetërore të burgut, por as para terrorit më të egër shatëror e tankeu dhe bajonetave serbe.

Bota përreth po e shikon me simpati gjithnjë më të madhe luftën e drejtë të popullit tonë dhe gjysb tasb mund të thuhet se është shqiptarë doli në pab në arenën ndërkombëtare si asnjëherë më parë. Vërtet që, duke qenë radiotelevizioni dhe shtypi kosovar zëdhënës të politikës shoviniste që ndjek qese rru e Beogradit, Kosova ishte pa gojë. Por, matanë kufirit, në shqipërinë mëmë, uqgllon Partia e Punës, e cila ngrii lart zërin e saj të fuqishëm në mbrojtje të popullit tonë të shtuarshqiptar. Dhe zërin e saj populli ynë i roberuar për këtë kufirit, e mori si zë të vetin dhe u bë me një gojë që flet shtruar e me argumente të ngjësura, sepse për bazë ka drejtësinë.

Njëherë, me ato që bëri e po bën në fashën e besëtyes populli shqiptar në Jugosllavi, me vendosmërinë e tij për të mos kurrë sakrificat në realizimin e aspiratave të ligjsbme, me trimërinë e tij të trashëguar përballë armiqve të egër e shumë më të mëdhenj, jo vetëm që maloniti botën, por u dha forca të pasdërshme edhe revolucionarëve, komunistëve e patriotëve të tij pararojë.

Me një popull që ka traditë si ky ynë dhe me një shkallë të ndërgjegjes së tillë shoqërore e kombëtare që ka sot populli dhe rinia jonë, forcat patriotike e revolucionare nuk kanë si të vënë fare në peshe mundin dhe sakrificat nga ana e tyre. Në burim të këtij populli dhe të këmbët e këtij populli, flimni dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme.

REDAKSHA

\* Deri më tash «Zëri i Kosovës» ka dalë në trajtë buletini dhe ka botuar materiale të përdorimit të broshurave për anëtarët e LNÇKVSH.

Deri në nr. , nëntor 1981 „Zëri i Kosovës“ ka dalë në trajtë buletini dhe ka botuar materiale të përdorimit të brendshëm për anëtarët e LNÇKVSH.

Në fund të vitit dhe në fillim të vitit 1982, Jusuf Gërvalla do t i nxjerrë dy numra të „Zërit të Kosovës“, si Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi.

Në 48-të vjetorin e rënies së birit besnik të Kosovës trime, Hasan Prishtinës, Jusuf Gërvalla në shkrimin me titull: Luftëtar deri në vdekje, ndër të tjera do të shkruaj: ... Hasan Prishtina, deputet e kryengritës, ishte nga të parët që demaskoi demagogjinë e xhonturqve pa u frikësuar nga egërsimi i tyre. Në këtë kohë ai zhvilloi një aktivitet të gjerë për krijimin e klubeve e të shkollave shqipe dhe në caktimin e një alfabeti të veçantë shqip dhe frymëzon e përkrah kryengritjen shqiptare të Kosovës më 1910 dhe të Mbishkodrës më 1911.

Duke demaskuar barbarizmat e osmanlinjve ai deklaroi në parlament: **“Jemi të mendjes që pushteti turk, po të mos mbrojtë politikën satanike të tij në Shqipëri, kryengritja do të përhapet në të gjitha anët e Shqipërisë, dhe pas pak do t'i bini kokës pas muri, por do të jetë shumë vonë”.**

Dhe u larguar nga parlamenti në shenjë proteste. ... Hasan Prishtina nuk i njohu vendimet e Konferencës së Londrës, që i lejoi monarkisë serbe të aneksojë Kosovën heroike, luftoi kundër tyre dhe nuk u pajtuar kurrë me këtë padrejtësi të madhe historike që iu bë kombit shqiptar. Që nga kjo kohë e deri në fund të jetës së tij prej patrioti të flaktë, ai punoi dhe luftoi me penë e me armë për mbrojtjen dhe

zhvillimin demokratik të Shqipërisë së pavarur, por edhe për shpëtimin e Kosovës e bashkimin e saj me Shqipërinë.

**Vëprim e jo fjalë,  
bashkim e jo përçamje**

*Vllazën! Kërkojnë prej nesh që atdheun ta trajtojmë si mall tregu. Jo, kurrë! Si dje, sot, nesër e përherë, atdheu ka qenë dhe asht gjaja ma e shëjtë për ne. Të gjithë ta dinë se na nuk jena tue luftue kundër Shqipnisë e shqiptarëve, por për një Shqipni të lirë e të bashkueme. Nuk kemi dalë maleve me shpëtue vetëm një shëpti, katund apo fis, po të tanë Kosovën, e cila mbështjell në gji-nin e vet krejt vllaznit, iqtetet e katundet tona. Ideja e parulla jonë ka qenë dhe asht: çlirimi e bashkimi i tanë Kosovës me atdheun tonë të përbashkët, Shqipërinë. Dhe për ta realizue këtë, dubet veprim e jo fjalë, bashkim e jo përçamje, trimmi e jo frikë. Na kurrë s'kemi kujtue se lirinë ka me na e sjellë dikush së jashtë. Jo, njëmji herë jo! Atë e kemi fitue dhe do ta fitojmë me gukun tonë, sepse vetëm kështu ajo mund të jetë një liri e vërtetë. Vetëm pushtka jonë e jo dikush tjetër ka detyrue e do të detyrojë anmiqtë të lëshojnë nga duert gërsbanët, me të cilat duen të qetbin copa të tjera nga trupi i atdheut tonë. E dimë se anmiku asht ma i shumtë në numër, ma i armatosun me armë dhe ma i pasun me spere. Kështu ka qenë dje, kështu asht edhe sot. Por kjo as nuk na tremb, as nuk na përkul, përkundrazi kjo kërkun që na të jemi ma të fortë. Të peshojmë mundësitë tona me guxim e mendje të kthjellër. Na nuk e zvogëlojmë rrezikun, në të kundërt, na u themi luftëtarëve: rreziku asht i madh, prandaj bashko-ni radhtë, tregoni vendosmëni e guxim, flakni tutje buracakët, që mbjellin përçamje e frikë, përbuzni ata që çirren tue na kësbi-llye të dorëzohemi, sepse gjoja do të shubemi.*

*Vllazën! Asht e vërtetë, se një gabim takik gjatë luftës mund të sjellë që kjo apo ajo çetë të t'hybet përkohësisht, por kjo s'ka aq rëndësi për fundin e luftës: Politika e dorëzimit, e prijes apo e kundërshtimit të aksionit kurrë nuk të çon në fitore. Kush ka frikë, ka me vete humbjen, kush qëndron i patundur, ka me vete fitoren. Liri pa gjak nuk ka.*

HASAN PRISHTINA

Gazeta „Zëri i Kosovës“ nr.2, janar 1982, fillon me botimin e fejttonit për Adem Demaçin, me titull: „Adem Demaçi – simbol i rezistencës shqiptare“.



**Adem Demaçi  
– simbol  
i rezistencës  
shqiptare**

*Në mos asgjë tjetër, 18 vjet  
të rënda derxjeje  
të Adem Demaçit  
nëpër kampet jugosllave  
të përqëndrimit  
si dhe 10 vjetet e tjera  
që i kanë mbetur atij  
për të mbajtur ende,  
vetëm e vetëm  
për bindjet politike,  
dëshmojnë për egërsinë  
e pashembullt  
dhe kalbëzimin e sigurt  
të Jugosllavisë titiste*

qiptare, me qeverinë e kralëve serbë.

Në prag të Luftës II Botërore, babai i Ademit u shpërngul në Prishtinë, bashkë me familjen. I shtrirë në moshë, pa kurrfarë pasurie, si që detyruar të punonte sharrëxhi në qytet, për të mbajtur gjallë familjen. Në këtë punë atij i ndihmonte edhe nëna Nazë, që nuk ishte vetëm nëna e Ademit, por e të gjithë neve.

Nëna Nazë gjatë tërë jetës punoi në veg dhe me punën e saj i bë kraht të shoqit në mbajtjen e familjes. Pasi vdiqes së plakut, nënës Nazë iu desh të bëhe edhe baba për tre fëmijët që i mbeten jetimë. Aj-shen, Maliqin dhe Ademën e vogël. Me vo-në nënës Nazë në mbajtjen e familjes i ndi-hmoi vëllau i madh i Ademit, Maliqi. Ai shpëste gazeta rrugëve, dytaneve e kalene-ve të Prishtinës, deri sa vdiq në lule të ri-nisë, nga tuberkuloza që e pat marrë pesh-qesh nga kushtet e vështira të jetesës, i zh-vështur, i zbatuar, i nangrëni.

Ademi, i vogël dhe shëndetlig siç ishte, gjatë okupacionit u regjistrua në shkollën fillore, të cilën e kreu pas lufte. Pastaj kreu gjimnazin e ulët dhe gjimnazin real (ku i dha mësim edhe profesori Zekirja Rexha). Dy vjet të fakultetit filozofik, de-ga e gjuhës dhe letërsisë shqipe, i kreu në Beograd. Më vonë i kreu edhe dy vjet të tjera në Fakultetin Juridik të Prishtinës.

Mbarimi i Luftës II Botërore Ademën e gjeti në moshën nëntë vjeçe. Megjithatë, ai ishte aq i zgjuar, sa edhe në atë moshë kishte ndjekur me interesim të madh shu-më ngjarje të kohës, që ishin preokupim për të rriturit. Torturat, vrasjet, masakrat që i bëheshin popullit shqiptar nga policia e fshehtë e xhelatit Tito, nga e ashtuqju-tura OZNA famëkeqe, e tronitë në shpi-r Ademën e ri. Kalonin vitet dhe, në vend që t'ia rrisnin trupin, ato ia prenë rritjen Ademit. Por, po rritet vullshëm në shpi-tin e tij ndaj të huajve mizorë, që plaçkitin popullin shqiptar, duke i marrë bagë-tinë, dritëharat, deri edhe bukën e gojës. Kur ndodhte të reagoje shqiptari për ga-bujtë që i bëheshin, kriminelët si Fera Re-shetari (të cilin e vrau shumë vjet më vonë Muharezen Thaçi, duke u hakmarrë për ba-banë e vet), e vrisnin pa mendur gjatë, në kohën e zezë të „otkupit“.

Dëshimi i popullit shqiptar nga trojet e veta, shfrytëzimet e padrejtësitë që i bë-heshin këtij populli, torturat e egra nën pretekstin e mbledhjes së armëve, Ademën e bënë një vullkan që vetëm priste momen-tin e shpërthimit.

**Romani i parë në Kosovë**

Që në ditët e gjimnazit, Adem Demaçi kishte filluar të merrej me shkrimet. Tregi-met e tij që në fillim ia tërhoqën vëmend-jen lexuesit kosovar. Ato të përgjithshni ki-shin ndëshkimit të shaktë...

Demaçi lufton vllavrasjen. Robërsitë ju-gosllave, të udhëzuar nga xhelati Tito, ki-shin krijuar kushte të atilla shoqërore, që nxitnin hakmarrjen dhe vllavrasjen me shqiptarëve. Ishte dora e kriminelit famë-keq Aleksandar Ranković ajo që t'onte praktikisht në vend këto porosi, duke zba-tuar parullën e mirënjohur „Fërça e su-nda“. Pos të gjitha atyre të keqajve që i bëheshin popullit shqiptar, edhe vllavra-sja e bënte të vetëm. Me qindra ishinq tërë që vriteshin mes vete, e shumë të tje-rë mbetnin të gjymtë nga plagët e rënda. Qindra e qindra të tjerë përfundonin në burgjet jugosllave, me qindra familje ng-joheshin në shtëpitë e tyre varfëruara nga frika e hakmarrjes.

Në fillim të romanit, Adem Demaçi thërrret:

*Jo atyne që janë trima  
Me ngrehë gjuhtin e krimin,  
Por atyne që janë trima  
Me zqarë dorën e pajtimin.*

Këto fjalë të Ademit u përhapen si rze-zë dielli në të gjitha trojet shqiptare të ro-bëruara nga Jugosllavia. Edhe kriminelët më të mëdhenj filluan ta prekin kokën. Kudo dëgjohehin fjalët: „Nuk asht trim-ni me vra vllan e me ia knaqë zemër du-shmanit, trimmi asht me e falë gjakun e me e ndalë vllavrasjen.“ Ndikimi që bënin shkrimet e Ademit të masat e gjera të po-pullit, bile edhe të ata që nuk dinin sh-krim-lexim po të tjerët u lexonin me zë romain, nuk mbeti pa u rënë në sy oku-patorëve jugosllavë. Adem, ndonëse ende shumë i ri dhe shëndetlig, në këtë kohë a-rinte t' i jepte rregullisht provimet (në Fa-kultetin Filozofik në Beograd), të punon-te si gazetar i rregullt i „Rilindjes“ në Pri-shinë dhe të merrej me shumë sukses me shkrimet letrare. Okupatori jugosllav e ndi-qe këmba-këmbës, duke e provokuar, du-ke i bërë presione e duke ia kërcënuar. Kë-to nuk mundën ta frikësonin Ademën e ta detyronin që të heshtë. Ai, i mellosur nga të gjitha të keqat që i ishin bërë e po i bëheshin popullit shqiptar, si në shkrim-et e tij letrare e gazetareke, ashtu edhe në çdo vend që e shihte të arsyeshme, e godiste pashetur okupatorin. Kërcënimet dhe presionet që i bëheshin, nuk e frikëso-nin, përkundrazi, gjithnjë i patundur, ai vazhdonte rrugën për patrioti e revolucio-nari.

Okupatori jugosllav bëri çmos që ta p-përveçte Adem Demaçin. Atij i premtom-in se do t' i plotësohej çdo dëshirë per-sonale, nëse pranon të bashkëpunojë me UDB-në dhe të lavdërojë në shkrimet let-rare e gazetare robrinë jugosllave. Por, as një presion e asnjë kërcënim nuk e përkul-li Ademën trupogjë e shpirtmadh. Nuk kaloi shumë kohë dhe Adem Demaçi u vunë pranng.

Vazhdon skanimi...

Pas bashkimit në janar, shkurt e maj 1982, „Zëri i Kosovës“, i cili ishte Organ i LNÇKVSHJ, do të botohet si Organi i Bashkimit të ri- LRSSHJ-së (LPRK-së). Në qershor 1982, në Gjermani me teknikën që kishte lënë dëshmori Jusuf Gërvalla vazhdon botimi i gazetës „Zëri i Kosovës“ me redaktor Skënder Durmishin, si Organ i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare Në Jugosllavi.

Ky numër i „Zërit të Kosovës“, do të botojë shkrimin e Jusuf Gërvallës: **„S’ju harron ju Kosova“**, Prishtinë 1976. Në këtë artikull ndër të tjera, Jusufi shkruan: - **„Një presion jashtëzakonisht të madh nga shumë drejtime i ekspozohet luftëtarit të lirisë kur detyrohet që aktivitetin patriotik ta vazhdojë jashtë atdheut. Nga ky presion ndodh që disa edhe të bien. Luftëtar i vërtetë dhe besnik mbetet vetëm ai, i cili në çdo hap të tij bazohet në interesat e popullit.**

**Qëndrimi i vendosur dhe lufta e popullit shqiptar në Jugosllavi janë ilaç më i mirë, në mos i vetmi për luftëtarin tonë në mërgim. Vetëm atëherë një luftëtar i tillë mund të quhet pjesë e pandashme e popullit të vet dhe jo vetëm nuk është degë e thyer dhe e thatë, por është burim, burim frymëzimi“.**

Zëri i Kosovës tanimë ka idhullin e vet, Jusuf Gërvallën, për të cilin do të shkruaj me admirim dhe mburrje dhe jo vetëm për këtë, po, edhe për dy martirët Kadri Zekën dhe Bardhosh Gërvallën, që e ndihmuan dhe i qëndruan afër Jusufit, deri në minutat e fundit të jetës.



Zëri Kosovës, u rilind si fryt i organizimit të forcave ilegale çlirimtare, që shpërthyen në demonstratën e vitit 1981, u rilind në kohën kur ishte domosdoshmëri e bashkimit të grupeve ilegale çlirimtare në një organizëm, u rilind pas aktit të krijimit të Lëvizjes për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, rilindi pra, si domosdoshmëri, që të shprehet si organ i kësaj force të sapoformuar, duke e afirmuar dhe stimuluar rezistencën tonë kombëtare.

Gazeta „Zëri i Kosovës“, do të bëhet tribunë e vetme që do t i afrojë me kohë Lëvizjes Çlirimtare një mbështetje politike të sinqertë. Pra, çlirimi, pavarësia e popullit tonë të pushtuar dhe bashkimi kombëtar, do të jenë përkushtim fanatik i kësaj gazete, duke qenë gjithmonë e hapur. Gazetë kjo që do të shkojë në duart e bashkatdhetarëve si një rreze e ngrohtë e diellit të Atdheut tonë, kudo në Evropë e Botë, duke pasqyruar ndërgjegjen e shumicës së shqiptarëve kudo që ndodhen, dhe që e ndjejnë veten krenarë që janë shqiptarë.

Zëri i Kosovës, si Organ i LRSSHJ-së, prej nr. 1 të vitit 1982 e deri në fund të vitit 1983, nuk del (për çdo muaj) rregullisht. U botuan vetëm tre numra.

# KOMUNIKATË

Përfaqësuesit e Lëvizjes Nacionalizmëtare të Kosovës dhe të Visëve të tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNCKVSHJ) dhe të Partisë Komuniste Marksiste-Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ) u mbledhën në 751-uror 1982 dhe zhvilluan bisedimet përfundimtare për bashkimin e këtyre dy organizatave në një të vetme. Pas arritjes së bashkimit, u vendos që organizatat të organizohen në Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi.

Në ndërkohë bisedimet u zhvilluan edhe me përfaqësuesit e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK) me të cilët bisedimet përfunduan më 15 Maj 1982.


Me një shkallë të lartë të unitetit të mendimit përfaqësuesit e të tri organizatave në mes tërësor morën këto vendime e qëndrime:

1. Që organizata e re të përqendrohet Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRSHJ).
2. LRSHJ—a si front unik i rezistencës do të përfshijë në gjirin e saj të gjitha forcat patriotike e revolucionare të popullit shqiptar, si dhe të gjithë patriotët në mërgim, të cilët për shkak të dhunës e terrorit serbo-madh janë detyruar t'i lënë trojet e veta të shtërlashtas;
3. LRSHJ—a do të luftojë për formimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (RSFJ) dhe të përfshihet në gjitha tërësitë etnike shqiptare, dhe për realizimin e këtij qëllimi do të shërbehet me të gjitha mjetet që lejon etika revolucionare: Duke u nisur nga bindja politike dhe gjer tek revolucioni i armatosur po që se e kërkon nevoja;
4. LRSHJ—a është tërësisht e bindur se duke luftuar për Republikën Shqiptare në kuadrin e federatës jugosllave do t'i kontribojë ruajtjes dhe forcimit të bashkimit dhe vëllazërimit të mirëfillt në mes popujve të Jugosllavisë, si përfaqësuese e vetme e popullit shqiptar në shtetin jugosllav. LRSHJ—a konsideron se lufta e saj e drejtë i shërben edhe forcimit të unitetit të federatës jugosllave, ruajtjes së paqes në Ballkan dhe stabilitetit të përgjithshëm në Europë e më gjërë;
5. LRSHJ—a hogaritet në ndihmën dhe përkrahjen e të gjitha forcave progresive të Jugosllavisë, të cilave u propozon luftë të përbashkët kundër forcave heqimniste, kolonialiste, shoviniste dhe forcave tjera reaksionare në Jugosllavi, të cilat kanë sot pozita dominuese në të gjitha strukturat e shtetit dhe si t'i tillë parqet rrezik permanent për të ardhmen e Jugosllavisë, për perspektivën e popujve që jetojnë në të dhe për paqen në këtë region;
6. LRSHJ—a me të gjitha forcat do të luftojë kundër cdo shovinizmi e separatizmi, sepse edhe këto izma reaksionare, që mund t'i parajten edhe tek ndonjë shqiptar, e dëmtojnë unitetin e Jugosllavisë dhe vetvetiu edhe luftën e drejtë që bëjnë popullit ynë;
7. LRSHJ—a përsëritet qëndrimin e drejtë të të gjithë opinionit progresiv ndërkombtar, që u solidarizua dhe po solidarizohet me kërkesën e drejtë të popullit tonë për republikën e vet në kuadrin e federatës jugosllave;
8. Përsëritet qëndrimi i PPSH-së dhe i qeverisë shqiptare ndaj kërkesës së klasës punëtore dhe popullit shqiptar në Jugosllavi për konstituimin e Republikës së vet në kuadrin e federatës jugosllave, me cka dëshmon interesimin e vet për këtë pjesë të kombit dhe principialitetit të politikës së jashtme ndaj RSFJ, ku respektohen me përpikëri parimet e mosqënitit të sovranitetit dhe integritetit territorial, mosprizimit në punët e mbrendshme, respektimit reciprok dhe barazisë së plotë në marrëdhënjet ndërkombetore dhe ruajtjes së fuqjisë së mirë, duke qenë gjithmonë në gadishmëri të plotë të mbrojtjes interesat e pjesës së kombit brenda normave dhe ligjeve ndërkombetare;
9. LRSHJ—a u bënë thirrje të gjitha grupeve egzistuese dhe individëve që luftojnë për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi që t'i bashkohen Lëvizjes për Republikë;
10. LRSHJ—a që tash distancohet nga të gjitha format e luftës që mbajnë erë terrorizmi dhe se s'do të ua shtrijë kurë dorën e pajtimit individëve që i kanë duart e zhytura me gjakun e popullit, gjithashtu Lëvizja s'do të bashkëpunojë asnjëherë me rrymat e organizatave politike që e mbajnë vulën e tradhtisë, apo qëllim ta rrezikojnë pavarësinë e RSFJ;
11. Organ qëndror i LRSHJ—së do të jetë «Zëri i Kosovës»;
12. LRSHJ—a u bënë me dije si OKB—së ashtu edhe qeveritë të të gjitha shteteve që janë për paqe, liri dhe demokraci në botë se pa një njohur popullit shqiptar në Jugosllavi statusi i kombit dhe e drejta e pajtëdhë të burgosur politik dhe pa mundësinë e kthimit në vendlindje të të gjithë atyre që luftuan për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, LRSHJ—a nuk do të qetësohet kurrë.

REPUBLIKA SOCIALISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI !  
RROFTE TE GJITHE POPUJTE E R S F J !  
RROFTE LEVIJZA PER REPUBLIKE !

Komiteti Qendror i Lëvizjes për Republikën Shqiptare në RSFJ

Gazeta „Zëri i Kosovës“ nr.2, shtator 1982 përveç që do të vazhdojë me fejonin për Adem Demaçin, do të botojë edhe letrën e parë, në emër të një milion shqiptarëve që rënkojnë të robëruar nën kthetrat e gjakpirësve dinakë e të pamëshirshëm... (më datë 29-VI-1963, Durim Drinasi me tregimin-MALIQI).



Adem Demaci

## MALIQI

Ditë e bukur tetori. Një rugë kambosore me botëse lëndë rumbullakë të hodhuan

I mbushun frymë tejet i lodhuan kalon  
tëhun e kodërve shovinistë që edhe  
për disa hapa të futet në një zabel të  
shpejtë.

Katoli dhe shtati i fundit—mendoi  
Maliqi dhe sytë i shkuen kah perëndimi.  
Dëgjoi nuk ishte më tërëse se një përk  
mbi horizont. Në qeli do të të përthima  
me skaje të purpurta. Një erë e flladhme  
para mangës shërb zabelit t'ua heqte  
fllatrat pahitëse si ndonjë zotë e madhnu  
eshme. Kjo freskon, t'fër djersë mbushë

shkolë gjindja kur shtyhej me pa se  
a vlinin gazetën. Por më kot, tanë rrafsh  
sa trena që erdhen nuk i përfund asetat.  
Kush e di se për shka nuk erdhen.

Maliqi shqiptar droshim të rrafsh  
thue se kishte pa ndonjë krim kundër  
tyne.

—Maliqi!— thirrë t'utit Mina.  
—Nasli!— Sytë tu mbushën me lot.  
—Maliqi, bre koke, shka u bë?  
—Nuk erdhen, vaji i plasi në za.  
Nasli për t'herë një ndiesi fortë.



Gazeta „Zëri Kosovës“, që nga shtatori i vitit 1982 ndërmerr aksionin për grumbullimin e të dhënave për të vrarët, të burgosurit, të përjashtuarit nga puna, shkolla e fakulteti; për të informuar popullin dhe opinionin ndërkombëtar, u mblodhën shumë emra dhe të dhëna përkatëse. Ato u botuan kohë pas kohe në Zërin e Kosovës.

Të dhënat i janë dërguar Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Amnistisë Internacionale (AI), qeverive, partive, organizatave demokratike përparimtare e humanitare, si dhe gazetave, gazetarëve dhe mjeteve të tjera të informimit. Ky aksion ka ndihmuar, që Amnistia Internacionale të kërkojë lirin e të burgosurve, proteston kundër torturave, u ndihmon në burgje, njëkohësisht ndihmon familjet e të burgosurve; informon opinionin ndërkombëtar, për gjithë atë terror që ushtrohet nëpër burgjet jugosllave mbi të burgosurit politik shqiptarë.

Zëri i Kosovës ka bërë një shërbim të madh për popullin, duke komentuar në mënyrë më të kompromentuar terrorin e torturat që po bënte klika shoviniste serbomadhe, ndaj bijave dhe bijve më të mirë të popullit tonë, të cilët me vendosmëri e guxim atdhetar rezistojnë këtë terror dhe për asnjë çast nuk lëshojnë pe nga kërkesat e popullit- për Republikën e Kosovës.

Në shtypin e Jugosllavisë nisën të botohen edhe letra e artikuj, që në një mënyrë ose në një tjetër, po e përkrahin luftën tonë të drejtë. Këto shkrime po u vijnë serbomëdhenjve si një dush i ftohtë në historinë e tyre shoviniste. Për shkak të objektivitetit dhe jehonës së letrës së Franc Kllopçiqit- slloven, kundër kësaj letre u ngrit i tërë llumi serb. Kjo letër me disa të tjera, na vijnë si zë bilbili në luftën mbrojtëse kundër peshkaqenëve serbomëdhenj, thotë Jusuf Gërvalla.

## THUANI TË VËRTETËN E PLOTË

**P**othuaj tashmë dy vjet problemi i Kosovës nuk zbrët nga faqet më të lexueshme të shtypit tonë. Shkaqet e drejtpërdrejta janë të ditura.

Ndjekin njëra-tjetrën informata, vlerësime dhe komente, ndër to ndonjëherë të tilla, të cilat ndeshen mes vete, rreth të cilave ngrihet polemikë brenda një kohe shumë të shkurtër. Përmes tyre shfaqen disa të vërteta, por në to nuk gjën përgjigje për të gjitha drithërimat.

Disa herë NIN-i botoi gjëra që morën në mbrojtje shqiptarët e Kosovës, por mbi to u hap menjëherë zjarr: jo edhe aq shkatërrimtar, por, para së gjithash, pak ose aspak bindës. Kam pritur që me kohë, përmes një durimi më të madh në të gjitha anët, deri në të cilin nuk është e lehtë rruga, të dalë më shumë e vërtetë për të gjitha ato që ndo-

Edhe në sllovenët vendoseshim, ri-vendoseshim, shkuleshim. — gjithçka ka pasur në të kaluarën. Historia thotë se sllovenët kanë pasur gjithashtu njëfarë „Fushë-Kosove të vetë“. Historike në të vërtetë Gosposvetsko-Pole, ku qëndron edhe sot mu në mes të një livadhi një fron nga guri, në të cilin të parët tanë sillnin duken e vet pas zgjedhjes. Sot kjo fushë është në Austri, e rrethon kryesisht popullin austriak — gjerman, dhe nuk ka kurrfarë shprese, as politike, për t'u ripërtëritur ajo fushë në mënyrën sllovene. Ka të disa sllovenë endë njëfarë nostalgjie për Gosposvetsko-Polen, por tek shumica e tyre është nocion i së kaluarës që nuk kthehet, rreth të cilit nuk duhet të ndiqet kurrfarë politike dhe për të cilin asnjë slloven nuk do të rrezikonte për ta trazuar paqen evropiane.

saj edhe parimisht, në pajtim me qëndrimet tona programatike.

Shqetësojnë deklaratat e tilla të banorëve që shpërngulen nga Kosova. Të cilat i jep Nadra Avdiq-Vllasi: Tash po shkoj, por kur të jetë nevoja do të vij. Çdo të thotë deklarata e tillë? Tolerancë? Premtim për nacionalizëm të ardhshëm hakmarrës?

Mendoj se është koha që të theksohet botërisht dhe me plot zërn e vërtetë e plotë shoqërore, pa marrë parasysh

dëmbajtje që mund të shkakto ajo të theksohet në mënyrë të paanshme të drejtë, bindese.

Duhet të theksohen në veçanti të gjitha kushtet ekonomike, politike dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës gjatë dhjetëvjetëshave të fundit, të përshkruhen të gjithë Kapitujt e shtyp-

Vazhdon letra...

Gjatë vitit 1983, me pëlqimin e shumicës së anëtarëve të Lëvizjes, teknika dhe redaktimi i Zërit të Kosovës kaloi në Zvicër, ku redaktor deri në vitin 1985 do të jetë **Xhafer Shatri**. Në ndërkohë, punime drejton edhe i arratisuri profesor Fazli Veliu, pas takimit me tre aktivistë; Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Ibrahim Kelmendi (në ndërrim vitesh 1981/1982).

Zëri i Kosovës në vazhdimësi do të botojë punimet në dorëshkrim të Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës. Pra, nr. 1, janar 1983 do të botojë shkrimin e Jusuf Gërvallës me titull: **T'i japim shtytje të re luftës** dhe letrën e hapur drejtuar punëtorëve kosovarë në mërgim të Kadri Zekës. Në të njëjtin numër do të botohet shkrimi për Kadri Zekën, me titull: „**Kadri Zeka: Një jetë për liri**“ .



*Varrezat qendrore në Shtuttgart, ku u varrosën dëshmorët: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla viti, 1982, që u vizituan dhe nderuan nga kombi ynë, deri në bartjen e Tyre në Kosovë.*

Selia e redaksisë do të jetë në këtë adresë: „Zëri i Kosovës“, BUCHANDLUNG, Badhausstr. 35, 2503 Biel – Bienne. Ndihamat për Lëvizjen dhe gazetën Zërin e Kosovës do të derdhen në këtë xhirrollogari: 25-45475, Hilfe für Kosova, Katharin Asal, 2503 Biel – Bienne, Suisse – Zvicër. Zëri i Kosovës nr. 7, 1983 do ta botojë dramën „Poeti martir“ në katër akte në vazhdimësi, ku bëhet fjalë për ditët e fundit të jetës së poetit patriot, Fazli Grajçevci, të cilin e mbyti mizorisht UDB-a jugosllave.



KATRIN ASAL DHE BEAT SHAFERI

## POETI MARTIR

*(Ne kete drame qe do ta botojme ne vazhdime behet fjale per ditet e fundit te jetes se poetit patriot, Fazli Graiqevci, të cilin e mbyti mizorisht udba jugosllave)*

( DRAME DOKUMENTARE NE KATER AKTE )  
PERSONAZHET

MESUESI – 25 vjeç	Dr. ALIU – 55 vjeç
NXENESIT – Filloristë	Dr. MORAQIÇI – 45 vjeç
MYRVETI – 20 vjeçe	DREJTORI I BURGUT – 43 vjeç
BABAI – 50 vjeç	RAGIPI – 28 vjeç
VLLADA – 45 vjeç	SPIUNI – plak
MILICET	TRI MOTRAT – 15 - 20 vjeçe
LLUKA – 40 vjeç	NXENESI 1 – Fillorist
IBRA – 35 vjeç	NXENESI 2 – Fillorist
MIRKU – 50 vjeç	ZERI I VAJZES
ÇEDA – 55 vjeç	HILMIU – 23 vjeç
	SAMIU – i vjetër

*( Në skenë shfaqet dhoma e mësimit, ku Fazli Graiqevci mban*

*Vazhdon skanimi...*

**GEZIMI:** *(Krejtësisht i tronditur)* Vetë e pashë kur na e morën mësuesin. Ia kishin lidhur duart mësuesit tonë të mirë...Ndoshta duan edhe atij t'ia bëjnë si mësuesit Negotani...

**NXENESIT:** *(Të gjithë të revoltuar fillojnë të dalin nga klasa)* Ku na e dërguan mësuesin tonë të dashur, kush ia lidhi duart mësuesit tonë të shtrenjtë, e duam mësuesin tonë, ose edhe ne na dërgoni te ai!

**MILICI:** *(Vërsetet mbi nxënësit me kërbac)* Jebraçu vam majku! Ua... Sve çu vas pobiti. Të gjithëve do t'ju mbysi! Svinje jedne, koke jedne! Derra!

*(Në skenë shfaqet një dhomë e vogël fshati, një shtrat i mbuluar me mblojë të bardhë, të qëndisur me figura të bukura. Një tavolinë me disa libra, fletore e revista, me dy karrige anash. Një doli i mbushur me libra të llojlloshëm. Fazliu i ulur në një karrigë. Myrveti duke qëndisur një mbështjellëse për fëmijën që prinin...)*

**MYRVETI:** – Nuk je vetëm ti poet, edhe unë jam njëfarë piktoreje, shih sa të bukura i kam bërë mbështjellëset për vogelushin tonë të ardhshëm.

Zëri i Kosovës, si organ i LRSZHJ-së, prej numrit 1 të vitit 1982 e deri në fund të vitit 1983, nuk doli për çdo muaj rregullisht. U botuan tre numra që përfshinë periudhën qershor – dhjetor. Në këto tre numra u botua vetëm një kryeartikull (nr. 2 shtator). Në këto tre numra u botuan një numër jo i vogël artikujsh të shkurtër, u botuan 14 fotografi të ndryshme (prej tyre kryesisht nga proceset gjyqësore

kundër bijve të popullit tonë që zhvilloheshin në Kosovë, dy fotografi nga pamjet e demonstratave në Kosovë dhe më me shumicë nga ato që zhvillonin bashkatdhetarët në Evropën Perëndimore). Në këto tre numra u botuan edhe pesë ilustrime. Gjatë vitit 1983 u botuan 7 numra të Zërit të Kosovës, në të cilët u përfshinë (veç punimeve tjera) edhe gjashtë kryeartikuj dhe pesë komunikata të redaksisë. Në këto 7 numra u botuan 22 fotografi të të burgosurve, 20 fotografi të tjera dhe 19 vizatime e ilustrime. Në vitin 1984, gazeta „Zëri i Kosovës“ u botua për çdo muaj, duke filluar prej shkurtit, i cili do të botojë Konventën famëkeqe Jugosllave – Turke, për shpërnguljen e shqiptarëve.

Biblioteka LIRIA Kolegjiumi i Redaksisë së Zëri i Kosovës do të botojë:

Në korrik të vitit , dramën „Procesi“ të Jusuf Gërvallës, shkrimtarit të shquar, revolucionarit tonë të madh, i cili deri në momentin e fundit me fjalën e tij të zjarrtë dhe me penën e tij të fuqishme, luftoi për lirinë e popullit shqiptar në Jugosllavi.

Më 6 maj 1984, u themelua Redaksia e Organit të LRSJH-së, duke e rritur nivelin e propagandimit, vlerat e artikujve nga përmbajtja duke shtuar numrin e ekzemplarëve. Biblioteka „LIRIA“ Kolegjiumi i Redaksisë së „Zëri i Kosovës“ do të botojnë, në shtator të vitit , në tërësi romanin „Gjarpijtë e gjakut“, të revolucionarit tonë, të parit romancier në Kosovë- Adem Demaçit. Pena e tij e fuqishme që në fillim preku plagën e madhe të popullit tonë:-vëllavrasjen...

Nr. 1  
Janar  
1985

# ZËRI I KOSOVËS



Organ i Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe të kombës së këtij populli, fluturojmë dhe vëckja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijë si përjetim më i bukur e më i fuqik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme.

Jusuf GËRVALLA

## YJE TE KOSOVES-NDRIÇUES TE RRUGES SONE DREJT LIRISE



**JUSUF GERVALLA**  
(1946 – 1982)

Populli ynë diti ta bëjë kërkesën Kosova Republikë, përkrahësi në një kohë të tillë kur edhe egjëztojnë kushtet më objektive për realizimin e saj pa marrë parasysh viktimit.



**KADRI ZEKA**  
(1953 – 1982)

Lëvizja revolucionare e popullit tonë nuk bëhet e vetmuar. Ajo bëhet pjesë në procesin revolucionar historik, që pa e transmetim nga themelet gjithë botën e vjetër të reaksionit kapitalist-revizionist dhe po i hap rrugën botës së re socialiste.



**BARDHOSHI GERVALLA**  
(1931 – 1982)

Kur një njeri apo një qeveri kryen një akt që dëton në kundërshtim me moralin e tij, të drejtë e të justuar dhe të shprehur me tanka, atë dëton ta vret ndërgjegjia, por regjimi i Beogradit nuk ka pikë morali e ndërgjegje.



**REXHEP MALAJ**  
(1951 – 1984)

Të organizuar dhe vetëm të organizuar, të bashkuar dhe vetëm të bashkuar, këtu dhe vetëm këtu qëndron garancia e fitores sonë.



**NUHI BERISHA**  
(1961 – 1984)

As që më ka shkuar mendja ndonjëherë të qëndrojë shumëjashër Kosovës. E ndiej veten luftëtarë të Ademit dhe dua të shkoj aty ku kontribuoj më së tepërimit.



**BAJRAM BAHTIRI**  
(1961 – 1984)

Ne s'kemi borsk askujt. Ç'kërkohet pushtesat në vatrën tonë. S'i dorëzohem për së gjalli të huajt! Nga vatrën tonë arruqë gjithmوند do të marrin plusmat e komunistëve shqiptarë – luftëtarëve të lirë.

Bijë dhe bijat e Kosovës, shokuj e dekadës, sa herë që që e duhur, iu përgjigjen zërit të masës, kërkesës së popullit dhe opinionit të tyre e vu në përballje rrezikëve për ta mbrojtur tokën, për ta realizuar lirinë! Me penë shkruan historinë, traditën, shpirtin e popullit të shumëllojshëm e të pamështruar, me gjak ngjyrosën Hamurin e kësaj ko mbitar, me saktësi bëjnë mu ranë të pashqyrcyeshme për armiqët pushtues, shfarosës, asimilues. Vitet e fundit, mbas shpërthimit të demonstratave masive në Kosovë, pëlojda revolucionare, kuadri i ri mbarrojtë e udhëzues, me përkatësinë e botës, me dëshirën e popullit për liri, u kacafut me armiqët e traditërit, sakrificoi e filloi, pësoi e mësoi, u detyrua të zikëst, por ngadhënjoi moralisht: hyri në zemrën e popullit, u bë gjak udhës e për rrijshën e pashkëputshme deri në fitorë, hyri në tingujt e çiftelisë, e mori me ndiesi për lirinë rapsodi popullor, e përqafoi brezi i ri, i frymëzuar nga veprimtaria e pranuam për liri! pëng, qra e fëmijë. Ky kuadër i ri, i frymëzuar nga veprimtaria revolucionare e vitëve qashtodhjetë – shtatëdhjetë, shpërthoi si vullkan në vitet tënditëstet, së bashku me masën marshoi e demonstroi dhe shprehja kërkoi: lirisë, punë, Republikë. Këtu shokuj nuk mund të ndalet as policia e Beogradit, as shtetëria vërshtues nga Nishi, Shkupit e të tjera vitë, as Illoçistët e rregullatëve serbo-maqedono-malazezomëdhenj. Mbas orës, postësore, mbas shtetërsthitimit, mbas shumëj burgoisive e vrasjeve në masë e kudo, u bë një ngjim i

(Vazhdon në faqen 3)

18

Zëri i Kosovës

Në vitin 1985 janar-korrik, dalin shtatë numra të Zërit të Kosovës, si Organ i LPRSSHJ-së. Në tetor të vitit 1985 „Zëri i Kosovës“ fillon të dalë si Organ i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), me ndryshimin e emrit të LPRSSHJ-së në LPRK, deri në fund të vitit dalin edhe tre numra tjerë.

Zërin e Kosovës pas rindërrimit të organizatës nga LPRSSHJ-së në LPRK, do ta përshkruaj fryma e shëndoshë kolegjiale e parimore, duke trajtuar problemet në esencë, duke shpjeguar drejt çështjet e ndryshme që shtroheshin për zgjidhje, e veçanërisht kërkesën e popullit për konstituimin e **Republikës së Kosovës me viset e saj** në kuadër të RFSJ-së.

Zëri i Kosovës duke e shtruar drejt dhe qartë me largpamësi luftën për zgjidhjen e çështjes shqiptare, do të depërtojë sigurt dhe shpejt në meset e punëtorëve dhe në Kosovë të kërkohet me të madhe. Redaksia e „Zërit të Kosovës“, si një Organ i LPRK-së, duke qenë në nivelin e saj të përgjegjësisë për të mbrojtur dhe çuar përpara vijën e shtruar të LPRK-së, do të bëhet faktor shumë i rëndësishëm i bashkimit të kurbetçinjve dhe unitetit të përbashkët në organizatën tonë të masave. Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, faktor i rëndësishëm, përmes organit të saj „Zërit të Kosovës“, ka luajtur rol vendimtar në drejtimin e luftës drejt statusit të Republikës së Kosovës.

Më 4 dhe 5 maj 1984, nga Komiteti Drejtues i LPRK-së është bërë redaksia e „Zërit të Kosovës“, me kryeredaktor, **Xhaferr Shatri**, anëtarët: Fazli Veliu, Mustafë Xhemajli, Saime Isufi, Emrush Xhemajli, Agim Hasan Malaj, Muhamer Shabani, Hasan Malaj, Ismet Rashiti etj. Ishte dhe vazhdonte të mbetet gazetë e vetme alternative në gjuhën shqipe, që iu kundërvu me sukses gjithë një mekanizmi të madh të propagandës jugosllave, në luftë kundër pushtuesit duke ngritur vetëdijen kombëtare të rinisë dhe të masave popullore e kurbetaçare.



Zëri i Kosovës nr. 2-3, nëntor – dhjetor 1985, në përvjetorin e 60-të të daljes së gazetës „**LIRIA KOMBËTARE**“, që botohej në Gjenevë të Zvicrës gjatë viteve 1925 - 1931, si Organ i Komitetit Nacional Revolucionar (KONAR), do të botojë në tërësi, Peticionin, që në emër të Komiteteve të Bashkuara Shqiptare, „Bajram Curri“ ia dërgoi Shoqatës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, në shtator të vitit 1924.

PERVJETOR

## DOKUMENTE TË PAKUNDËRSHTUESHME

Në këtë vit publicistika dhe gazetaria shqiptare ka shënuar një përvjetor të rëndësishëm: 60-vjetorin e fillimit të daljes së gazetës «LIRIA KOMBËTARE», që botohej në Gjenevë të Zvicrës. «Liria Kombëtare» doli gjatë viteve 1925 e deri në vitin 1931, në çdo javë, si organ i Komitetit Nacional Revolucionar (KONARE).

Kjo gazetë luajti një rol të madh në jetën politike e shoqërore të dekadave të para të këtij shekulli.

Në këtë gazetë u botuan artikuj, ku shprehen mendime politike mbi situatën kombëtare e ndërkombëtare, mbi problemet e klasës punëtore, fshatarësisë, sundimin satrapian të Zogollit, shprehen haptazi dhe në mënyrë të faktuar gjendja reale e mjerimeve, masakrave dhe terrorit mbi shqiptarët nën sundimin e Mbretërisë SKS,

duke u bërë të gjitha këtyre analizë të drejtë e të qartë.

Në organin «Liria Kombëtare» dhe në KONARE ishin tubuar figura të shquara si Fan NOLI, Halim XHELO, Avni RUSTEMI, Dr. Omer NISHANI etj.

Në këtë numër të «Zërit të Kosovës» po botojmë, pothuajse në tërësi, PETICIONIN, që në emër të KOMITETEVE TE BASHKUARA SHQIPTARE, Bajram CURRI ia dërgoi Shoqatës së Kombeve në Gjenevë, në shtator të vitit 1924.

Këtë PETICION, me titullin «DOKUMENTE TE PAKUNDËRSHTUESHME», me një sqarim paraprak «Liria Kombëtare» e botoi më 19 gusht 1925.

### SI VEPROJNE SERBËT NE KOSOVE

Po botojmë më poshtë një dokument të një rëndësie të madhe, i cili iu dorëzua Shoqatës së Kombeve, në muajin shtator të vitit 1924, nga kryetari i Komitetit të Kosovës, Bajram Curri. Ky ishte akti i fundit, që Garibaldi i Shqipërisë, siç e quanin gazetaret italianë, kishte bërë për vëllezërit. (...)

minoriteteve, por kanë shkruar aq larg që t'u mohojë edhe të drejtat për të jetuar.

Në fakt nga ajo që del prej dokumenteve më poshtë të përfshira janë një rezymë të veprimeve të serbëve kundër shqiptarëve në tokat e tyre:

### 1. ORGANIZIMI I BANDAVE TE ARMATOSURA

Nën emrin e organizatave nacionale shteti SKS ka organizuar ba-

*Vazhdon dokumenti i skanuar...*

Në vitin 1984, Zëri i Kosovës u botua për çdo muaj. Dalin 12 numra, duke filluar prej shkurtit. Veçanërisht i rregullt, doli nga muaji maj, kur më 6 maj të vitit 1984 u themelua Redaksia e organit të LRSSHJ-së. Gjatë këtij viti u botuan 11 artikuj dhe po aq komente. U botuan 77 fotografi, 38 vizatime, ilustrime, grafika, karikatura e portrete. Niveli i propagandimit, vlera e artikujve nga përmbajtja u ngritën mjaft lart.


Në vitin 1985, (periudha janar – korrik) dolën edhe shtatë numra të « Zërit të Kosovës » si organ i LRSSHJ-së.

Nga tetori 1985 « Zëri i Kosovës » fillon të dalë si organ i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK-së), me ndryshimin e emërimit të LRSSHJ në LPRK, që deri në fund të këtij viti dalin tre numra, me fizionomi më të plotë dhe të vënë edhe në bazë më të shëndoshë. Gjatë vitit 1985 u botuan 10 artikuj dhe po aq komente. U botuan 169 fotografi të të burgosurve politikë dhe të vrarëve në Kosovë nga armiku serbo-maqedono-malazezomadh. U botuan edhe 19 fotografitë tjera dhe 10 ilustrime e grafika. Prej tetorit 1985 cilësia e artikujve u rrit në nivel shumë më të lartë se deri në atë kohë. Në vitin 1986 dolën 11 numra të « Zërit të Kosovës » organ i LPRK-së. Numri 1 dhe 2 i këtij viti u botua para ndarjes së fundit në LPRK.

U botuan dy kryeartikuj dhe një koment, si dhe 24 fotografi e 4 ilustrime. Në numrat vijues u botuan 7 kryeartikuj dhe 6 komente. „Zëri i Kosovës“ filloi të dalë

edhe më me kualitet, si në përmbajtje ashtu edhe në përgatitjen teknike e artistike, u botuan 55 fotografi prej të cilave 41 të të burgosurve dhe të vrarëve nga armiku. U botuan 7 vizatime e ilustrime. Në vitin 1987 deri në Mbledhjen e Parë të Përgjithshme dalin 6 numra të „Zërit të Kosovës“ (dy prej tyre, dynumërsh), u botuan 4 kryeartikuj dhe dy komente. Vetëm deri në korrik 1987 u botuan shumë fotografi të të burgosurve politikë dhe të vrarëve nga armiku dhe 11 ilustrime e portrete.

Niveli i vlerave të artikujve përgjithësisht është rritur dukshëm, si rezultat i përcjelljes së situatave dhe gjendjes aktuale në Kosovë, si dhe përgatitjes e punës kolegjiale të Kolegjiut të Redaksisë së „Zërit të Kosovës“ ...



Mbledhja e Parë e Përgjithshme e LPRK-së (sot LPK), 1987, Udhëheqësit e Lëvizjes (brenda-jashtë vendit (Ahmet Haxhiu) jashtë të njohurit: Anëtarët e Kryesisë, të Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së.

Kolegjiumi i „Zërit të Kosovës“ përgatiti dhe thirri Mbledhjen e Parë të Përgjithshme të LPRK-së. Në Korrik 1987, Mbledhja e Parë e Përgjithshme e LPRKsë e cila u zhvillua në St. Gallen, vazhdoi në Zürich dhe përfundoi në Delemont, përveç aprovimit të Programit dhe Statutit të LPRK-së, të rezolucioneve dhe zgjedhjes së udhëheqësisë së re, në krye me Prof. Fazli Veliu, zgjodhi edhe Redaksinë e „Zërit të Kosovës“ me redaktor **Mustafë Xhemajlin**. Në përbërje të redaksisë ishin: Fazli Veliu, Avni Dehari, Destan Hajdini, Ismet Rashiti dhe Beqir Beqa.

Zëri i Kosovës duke qenë gjithmonë në shërbim të çështjes kombëtare, ka bërë njoftimin e drejtë dhe sqarimin e masave të gjëra, si në Kosovë me vise, ashtu edhe në diasporë. Ka ndikuar në masë të madhe për orientimin e të rinjve drejt realizimit të aspiratave tona.

Kolegjiumi i Redaksisë duke i botuar kohë pas kohe punimet shkencore të studiuesve shqiptarë në gjuhët e huaja, bëri të mundur që opinioni i jashtëm dhe opinioni i gjerë jugosllav, të informohet në mënyrë më të përafërt me ideologjinë dhe politikën serbomadhe, gjithherë sundimtare, që nga koha e Ilija Grashaninit, përkatësisht e „Naçertanies“ së tij famëkeqe të viti 1844. Një punë të tillë do ta bëjë gati pas një dekade, që nga viti 1988 e përjavshmja e Zagrebit „Danas“, gazeta „Borba“ e gazetat tjera.

Zëri i Kosovës ishte organ i LPK-së, në përkrahje të çdo lëvizjeje përparimtare (që punonin), sidomos për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare. Ishte me qëndrime të prera kundër armiqve tanë që copëtonin pa mëshirë vatrat shqiptare dhe kundër të gjithë atyre që me paturpësi u munduan që pushtuesit t'i paraqesin të pathyeshëm dhe përhapnin me marifet demagogjite e tyre për „pafuqinë“ tonë kombëtare, pesimizmin, dorëzimin, çorganizimin dhe pritje të lirisë nga qielli! Ishte gazetë (atdhetare) idealiste e jokomercialiste. Nuk ishte gazetë e dalë nga porositi e zyrave antishqiptare të Beogradit.

Përkundrazi, u gjend përherë e goditur nga UDB-ja dhe bashkëpunëtorët e saj, për t'u asgjësuar dhe shuar. Zëri i Kosovës do t'u qëndrojë goditjeve të egra mbi fjalën e lirë shqipe, sepse ajo në bazën e saj kishte vullnetin e popullit për liri.

*Pra, Zëri i Kosovës, do të mbetet zëri i lirisë kombëtare, që kishte caktuar, qëllimin për ku ishte nisur, duke e thënë të vërtetën, ashtu si ç'ishte, edhe atëherë kur ishte e hidhur. Ecte gjithmonë para lexuesve dhe e trasonte rrugën në fushën e mendimit e të studimit real të mbështetur gjithmonë në fakte të kohës. Ishte një tribunë e vetme dhe e hapur e mendimit shqiptar, duke qenë këmbëngulëse në ngritjen e çështjes kombëtare, pa u frikësuar se do të jetë pakicë e mendimit shqiptar. Duke dhënë kontributin e pakursyer në çlirim dhe realizim të pavarësisë së plotë kombëtare dhe në ndërtimin e shoqërisë demokratike, do të jetë zëri i ndërgjegjes, zëri i lirisë, zëri i*



*shpresës për lirinë e Kosovës, zëdhënës i Kosovës martire dhe i idealeve të Lëvizjes Kombëtare të Kosovës, interesave kombëtare, pavarësisht konjunkturave politike.*

Zëri i Kosovës përcolli sakrificat e mëdha të atdhetarëve shqiptarë, dënimet e vazhdueshme që mbi ta bënin pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre. Mbante lart moralin e sakrificës së pandërprerë kundër pushtuesve serbo –malazezo - maqedonas, duke demaskuar me kohë planet antikombëtare të pushtuesve.

Demaskoi egërsimin e shovinizmit serb në rritje, i cili suprimoi autonominë e Kosovës, duke i dhënë përkrahje të pakufishme grevave të punëtorëve, minatorëve dhe demonstratave që shpërthyen në mbrojtje dhe të avancimit të saj në Republikë. Zëri i Kosovës ishte më i fortë se gjithë propaganda e egër sistematike serbe dhe ajo antishqiptare e ingranazheve serbe të ndërtuara në Kosovë si LKJ, LSPP, LRS etj, që tentonin të mbytnin zërin e lirisë, zërin për pavarësi kombëtare.

Zëri i Kosovës ka publikuar fotografitë e të burgosurve politikë deri në vitin 1988, praktikë të cilën do ta vazhdojë edhe më tutje. Herë pas herë ka botuar edhe artikuj të veçantë, peticione, lajme, letra e informata për qëndresën e lartë të të burgosurve politikë; simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçit, Kadri Osmanit, Hydajet Hysenit dhe për qëndresën sublimë të Fazli Grajçevcit, Afrim Abazit, Zija Shemiut e të tjerë, por e gjithë kjo ishte vetëm një pjesë nga ajo heroika madhështore e qëndresës së pashembullt të bijve e bijave të popullit prapa grilave. Duke pasqyruar në vazhdimësi në faqet e veta, përpjekjet dhe qëndresën e të burgosurve politikë shqiptarë, para gjithë opinionit të brendshëm dhe atij të jashtëm botëror, paraqet jo vetëm gjendjen reale dhe tepër të rëndë, të të burgosurve politikë shqiptarë, por edhe ndihmon luftën e popullit tonë duke denoncuar politikën shoviniste e barbare të armikut.

Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, duke siguruar, mbledhur dhe botuar këto dokumente në Organin e saj, „Zërin e Kosovës“, ka ndihmuar luftën e popullit tonë, denoncuar politikën shoviniste e barbare të armikut dhe ka dëshmuar para botës për pozitën e të burgosurve politikë dhe të mbarë popullit tonë. Zëri i Kosovës nr. 10, tetor 1987, në 25 vjetorin e mbajtjes të padrejtë në burgjet e Jugosllavisë simbolin e rezistencës kombëtare dhe shkrimtarin e talentuar – Adem Demaçi, do të shkruaj për veprimtarinë atdhetare dhe qëndrimin e pathyeshëm të Adem Demaçit, për jetën dhe kushtet në burgun e Stara – Gradishkës.

## BIJTE DHE BIJAT E KOSOVES NUK I NDANE NGA POPULLI AS BURG, AS PLUMBI

*Këtë vit u mbushën 25 vjet që mbabet pa të drejtë në burgjet e Jugosllavisë biri i shtrënit i popullit tonë, simboli i rezistencës kombëtare, ideologu e udhëheqësi i shquar i lëvizjes patriotike e revolucionare të Kosovës dhe shkrimtari i talentuar - ADEM DEMAÇI.*



ADEM DEMAÇI  
25 vjet burg – Simboli i rezistencës kombëtare

Gati gjysmën e jetës Adem Demaçi po e kalon në burgjet e rënda të Jugosllavisë. Po kaç vite populli rënkon nën çizmën e re, nën zgjedhën e re serbo-maqedono-malazezomëdhenjve. Pandalur biri i këtij populli kërkon të drejta kombëtare, pandalur populli kërkon lirinë e birit të tij besnik e të gjithë atyre që u burgosën gjatë dekadave të mëvonshme, e sidomos gjatë viteve të '60-ta e '70-ta, veçmas pas ngjarjeve revolucionare të vitit 1981. Por, pushtetmbajtësit, të prirë nga pasionet e sëmurura e të rrezikshme për të sunduar popullin tonë, vazhdojnë traditën e krajlëve, të fashistëve në krye me V. Çubrilloviçin, të xhelatëve në krye me Rankoviçin, Gjilasin, Vukmanoviç-Tempon, Herleviqin e të tjerë si këta.

Adem Demaçi qëndron i paepur sikur edhe vetë populli ynë, është shëmbëllyesi më i mirë i popullit që nuk ndalet në udhëkryq, por kërkon haptazi të drejtat e tij si popull e si komb.

Në vitin 1958 Adem Demaçi arrestohet për herë të parë dhe akuzohet për propagandë kundër regjimit. Qëndrimi i tij revolucionar në burg ishte e është frymëzim i madh për popullin. Dënohet pesë vjet burg, prej të cilave i mban tri vjet në burgun e Mitrovicës së Sremit. Nga burgu doli në vitin 1961. Në vitin 1963 hartoi projektthirrjen «Vëllezër e motra», dhe është aktivisti kryesor në rrethet e organizuaru revolucionare. Më 1964 hartoi Projektprogramin dhe Projektstatutin e *Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH)*. Më 8 qeshor 1964 arrestohet për herë të dytë. Dënohet 15 vjet burg si ideolog i LRBSH dhe dërgohet në Nish. Pas një greve të gjatë afër një muaji që e bëri me shokët e transformojnë në burgun e Pozharevit. Pas një amnestie të përgjithshme, që u bë pas rënies së Rankoviçit, edhe Ademiti i zbritet dënimi nga 15 në 10 vjet. Nga burgu i Pozharevit doli më 8 qeshor 1974.

Në dhjetor të vitit 1975, UDB-ja nga frika e autoritetit të Adem Demaçit e burgosi atë më 18 shqiptarë të tjerë. Në gjykimin e montuar Adem dënohet me 15 vjet burg. Tani gjendet në burgun e Stara Gradishkës.


Që nga viti 1958 Adem Demaçi është burgosur e riburgosur, munduar e tortuaruar, sa edhe vetë populli që provoi shtypjen, dëbimin, fushatën e asimilimit, vrasjet e bijve më të mirë.

Është i vetmi rast në Evropë, po dhe në botë, që një i dënuar të mos lirohet nga burg, përkundër të gjitha kërkesave e protestave të autoriteve, të grupeve, organizatave e shoqatave të shkrimtarëve.

Adem Demaçi përfshinë gjithë kohën e lëvizjes revolucionare, e cila kaloi në disa faza (deri me sot te MLK dhe LPRK), të cilat mbarshtuan kërkesat e popullit tonë për të fituar të drejtat e lirite kombëtare e klasore.

(Vijon në faqe 2)

Në tetor 1987, në kuadër të Bibliotekës „Liria“ të Kolegjiut të Redaksisë së „Zërit të Kosovës“, u botua në gjuhën gjermane libri kushtuar Adem Demaçit me titull: „Gjarpijtë e Gjakut“. Libri i botuar si manual-skript, i dedikohet opinionit të huaj për ta njohur më mirë shkrimtarin e talentuar dhe patriotin e shquar – simbolin e rezistencës kombëtare, i cili 28 vjet me radhë qëndron ballë për ballë shovinistëve serbomëdhenj, i pathyeshëm e gjithmonë ngadhënjimtar.



Në libër janë të përfshira: një parathënie e gjerë mbi jetën dhe veprimtarinë e Adem Demaçit; një fragment i gjatë i romanit më famë Gjarpinjtë e Gjakut; fjala e Jusuf Gërvallës për Adem Demaçin; një parathënie shpjeguese për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi dhe telegramin protestues që Shoqata e Shkrimtarëve të Suedisë ia dërgoi Kryesisë së RFSJ-së në tetor të vitit 1987.

## HERONJTË DHE ADEM DEMAÇI LEGJENDAR - UDHËRRËFYES NË RRUGËN TONË TË NDRITSHME

Jusuf Gërvalla, shkriu çdo qelizë, deri në momentin e fundit të jetës së tij, duke ndritur rrugën e popullit të varfër me penë e me gjak. Nxori në sipërfaqe padrejtësitë, sheshoi të vërtetën para opinionit, para popullit të vet përmes „Zërit të Kosovës“.

Kadriu, me përkushtim prej atdhetari, i lidhur më shokët dhe me ngjarjet në Kosovë, doli hapur para masës, sepse e kërkoi koha. Sqaroi dhe organizoi me shokët dhe udhëhoqi demonstratat dhe marshimet protestuese me masën e mërgimtarëve në kryeqendrat Evropiane. Për të sqaruar e ngritur masën, popullin, nxori me shokë revistën „Liria“, përgatiti nga shtypi i huaj përmbledhjen „Jehona e ngjarjeve në Kosovë“; përgatiti përmbledhjen kushtrihtarë të revolucionarëve kosovarë „Këngët e Lirisë“ ...

Bardhosh Gërvalla, i qëndroi pranë vëllait dhe shokëve. Bashkë me ata luftoi duke sqaruar masën, duke ndihmuar bashkatdhetarët, pa u kursyer.

Rexhep Malaj dhe Nuhi Berisha i dhanë krah dhe fuqi luftës, moral e forcë popullit. Rexhep Malaj si anëtar i Lëvizjes revolucionare duke i përhapur idetë atdhetare në mesin e gjimnazistëve të Gjilanit, bëri për veti shokët më të mirë: Kadri Zekën dhe Hydajet Hysenin, me të cilët do të vazhdonte me hov të madh luftën për liri. Vala e arrestime të vitit 1974 përfshiu edhe Rexhep Malën, i cili gjatë hetimeve, në gjyq dhe gjatë 8 vjet burgimi, do të qëndrojë i papërkulur para organeve të UDB-së.

Me të dalë nga burgu do të vazhdojë luftën e nisur. Amaneti i shokëve të rënë dhe burgosja e shokëve e shtynë të hidhej më me vrull për të kompensuar humbjen e tyre. Pa humbur kohë, gjeti bashkëluftëtarin Nuhi Berishën, me të cilin bënë një gjallërim të menjëhershëm të aktivitetit revolucionar në Kosovë, duke marrë kontakte e koordinuar veprimtarinë me grupe dhe organizatat, që ishin duke veprua nëpër të gjitha viset nën Jugosllavi.

Veprimtaria e dendur nga Rexhepi dhe Nuhi Berisha në Kosovë, shtoi edhe survejimet. Më 12 janar 1984 u rrethuan në befasi me policinë speciale Jugosllave, qëndruan deri në fund, duke vrarë shumë policë, ndërsa vetë para rënies, ia morën këngës „Dalëngadalë po vjen behari“. Me këtë, ia bënë me dije regjimit jugosllav se, që tash do t i përgjigjemi armikut flakë për flakë.

I frymëzuar nga rënia heroike e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, edhe Bajram Bahtiri në mes të Prishtinës, qëndroi deri në frymën e fundit, duke luftuar me njësitin special dhe bie në fushën e nderit, ashtu siç ranë Rexhepi dhe Nuhiu.

Zija Shemsiu duke mos hequr dorë nga letra, duke mbrojtur vendosmërisht konstatimet e letrës që iu kishte dërguar Kryesisë së RSFJ-së nga të burgosurit

politikë shqiptar, me rastin e 4-vjetorit të demonstratave, të cilën e firmosi me dorën e tij dhe e vulosi edhe me gjak.



*Zëri i Kosovës, nr. 1-2, janar-shkurt 1988, vizatim nga Muhamer Shabani*

Rënia e këtyre dëshmorëve dhe qëndresa heroike e Adem Demaçit, do të bëhen fanar ndriçimi në rrugën për Liri. Populli po merr forca nga qëndresa e bijve të tij, si nëpër burgje jugosllave, po ashtu edhe nga heroizmat ballë për ballë me armiqhtë.

Në mars 1989, në valën e demonstratave mbarëpopullore në Kosovë, gazeta „Zëri i Kosovës“ boton organin „Mianatori“, si buletin. Numri i parë do të botohet në muajin mars dhe do të shpërndalet, ndërsa nr. 2 u botua dhe u shpërnda gjatë muajt mars me titull: **„Për Liri e barazi – populli ynë masovikisht po kundërshton zgjedhën e robërisë shoviniste serbomadhe“**.

Kolegijumi i Redaksisë së „Zërit të Kosovës“ e ribotoi „Minatorin“ me qëllim sa më të drejtë me rrjedhën e demonstratave atdhetare gjatë muajit mars në Kosovë.

Në valën e demonstratave gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 1989, brenda në Kosovë dolën numri 5 (shtator-tetor 1989) dhe numri 6 (nëntor-dhjetor 1989) i „Rrugës së Lirisë“, buletin i „Zërit të Kosovës“. Në nr. 5 u botuan përveç artikujve për gjendjen në Kosovë edhe Komunikata e Rezolucionet e Mbledhjes së Dytë të Përgjithshmet të LPRK-së, si artikulli „Asnjë gram xehe – asnjë kilovat rrymë pushtuesit“, shkruar nga Afrim Zhitia dhe letra përkrahëse e popullit slloven, dërguar më 30 nëntor 1989, nga LPRK-ja.

Në nr. 6, botohen 9 artikuj dhe Peticioni i Studentëve të Universitetit të Prishtinës, ku kërkohet më këmbëngulje mosndërrimi i emrave të rrugëve dhe institucioneve, dërguar organeve komunale, krahinore, organeve të Serbisë dhe atyre federative.

# RRUGA E LIRISE

Buletin i «Zërit të Kosovës», organ i LPRK • Viti II i botimit • Nr. 1, janar-shkurt 1990

Gazeta „Zëri i Kosovës“, nga janari i vitit 1991, përveç që do të bashkëpunojë me gazetën Demokracia autentike në Lubjanë- gazetë e pavarur e grupit të intelektualëve shqiptarë në Slloveni, me kryeredaktor Mr. Ukshin Hotin, pas një kohë bukur të gjatë, studimi, analize për një rubrikë Letra në Redaksi, do të fillojë edhe më këtë rubrikë.

Të dashur e të nderuar lexues të «Zërit të Kosovës», ja filluam me rubrikën e re «Letra në Redaksi», rubrikë e cila do të jetë krejtësisht e juaja. Kähler kemi menduar për një rubrikë të tillë ashtu siç keni menduar, e, siç jeni shprehur në qindra e qindra letra që deri tash na i keni dërguar në Redaksinë tonë. Letrat tuaja, në punën tonë, na kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Të gjithëve Redaksia ju falenderon.

Pra, kjo rubrikë është juaja, ju e keni formuar, urdhëroni e mbajeni me letrat që do t'i dërgoni për botim. Redaksia e «Zërit të Kosovës», do të jetë e kënaqur, sikur ju, lexues të nderuar, të na shkruani letra ku do t'i shprehni mendimet e juaja, vizionet, preokupimet, sugjerimet, vërejtjet, kritikën, sepse me të drejtë një lexues na shkruan: Redaksia e ZERIT TË KOSOVES të mos pres vetëm lavdata! Plotësisht me vend: Nuk është koha e lavdatave! Është koha për punë e mendime konstruktive që na çojnë përpara, që ndihmojmë çlirimin e Republikës së Kosovës.

Ne po e nisim rubrikën tuaj me këto letra që ishin më aktualët për kohën, varet nga ju, lexues të ZERIT, sa do të jetojë kjo rubrikë.

**REDAKSIA**

Në tetor 1991, kryeredaktor i „Zërit të Kosovës“ do të zgjidhet Avni Dehari. Anëtarë të redaksisë: prof. Fazli Veliu, Destan Hajdini dhe Beqir Beqa. Po këtë vit, Këshilli i Përgjithshëm i LPRK-së cakton Beqir Beqën redaktor të „Zërit të Kosovës“. Anëtarë të redaksisë: prof. Fazli Veliu, Faik Racaj, Xhevat Bislimi, Haki Morina, Atdhetar Labënishti, Mustafë Emiri, Jusuf Ismaili, Koço Danaj (edhe pse nuk ishte anëtar i LPRK-së, po ishte pjesë përbërëse dhe shumë aktiv në redaksi).

Bashkëpunëtorë të përhershëm të redaksisë ishin: Muhamet Kelmendi, Gafurr Elshani, Emrush Xhemajli, Ibrahim Kelmendi (i cili ka dhënë një kontribut të veçantë që nga fillimi i daljes së gazetës „Zërit të Kosovës“ në diasporë. Nga selia shumëvjeçare në Biel/Bjen, Zëri Kosovës, kalon me seli në Lozanë, në Rue de Geneve 10, deri në shpërngulje në Aarau.



*Objekti i Shoqatës Kulturore të Shqiptarëve të Kosovës Pjetër Bogdani në Biel (Kolegjiumi i Redaksisë së Zërit të Kosovës)*



*Objekti ku ka qenë redaksia e „Zërit të Kosovës“ në Lozanë.*

Në fillim të shkurtit 1992, Redaksia e „Zërit të Kosovës“, nën drejtimin e Beqir Beqës me anëtarë të tjerë të redaksisë, në kuadër të riorganizimit të vet, ka formuar edhe sektorin për parapagim dhe dërgimin e rregullt dhe në kohë të gazetës dhe sektorin e librit. Prandaj të gjithë të interesuarit mund të parpagojnë në këtë konto:

**BANQUE CANTONALE VAUDOISE (CH)**  
**1002 LAUSANNE**  
**C. 219.108.8 767**  
**ASSOCIATION ZËRI I KOSOVËS**

Deri në fillim të shkurtit 1992, Zëri i Kosovës ishte gazetë mujore. Në kohën kur pushteti okupues serb, po pengonte në mënyrë sistematike me të gjitha format informimin tonë dhe kur tek bashkatdhetarët nuk po arrinte edhe ai pak shtyp që po dilte në Kosovë, Këshilli i Përgjithshëm i LPK-së, për të dhënë një kontribut modest në plotësimin e zbrazëtirës së madhe informative, vendosi që gazeta « Zëri i Kosovës » të dalë dy herë në muaj. Që nga shkurti 1992, Zëri i Kosovës do të dalë në shitje më datë 1 dhe 15 të çdo muaji. Ai do të shtypej në 12.000 ekzemplarë dhe do të shpërndahej nëpër vende të ndryshme të Evropës. Ishte kërkesa e anëtarëve të LPRK-ës, e simpatizantëve dhe mërgimtarëve shqiptarë, që ishin lexues të rregullt të « Zëri i Kosovës », prandaj kërkonin që të dalë në çdo 15 ditë.

Zëri i Kosovës, Organ i LPK-së, si gazetë pluraliste ishte një ndër gazetatat në morinë e mjeteve të informimit shqiptar, ishte vërtetë Zëri i Kosovës, Zëri i popullit të saj, që me dekada derdhi gjakun, djersën dhe mundin e vet për liri dhe pavarësi kombëtare. Vazhdimisht ka ndjekur me besnikëri rrugën e zgjimit dhe të vetëdijesimit politik të Popullit në drejtim të luftës për liri, si dhe të të gjitha përpjekjeve të mundshme drejt lirisë.

Pra, gazeta « Zëri i Kosovës », jo vetëm që propagandoi sukseset e luftës çlirimtare, por edhe siguroi të dhëna të sakta nga terrenet e luftës. Vazhdoi të përhapë midis njerëzve frymën e krenarisë e të guximit për t'u ndeshur me armiqtë, dhe jo siç bënin mediet tjera që përhapnin frikën e panikun (nga masakrat masive që sipas tyre do të bënin serbët po t'u kundërviheshim).



**Adem Demaçi, Ahmet Haxhiu, Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani dhe Ali Ahmeti Mbledhja e përbashkët (brenda-jashtë), 1992, Lucern, kur Adem Dema (Demaçi) nisi gjeneratat drejt Kosovës: për Liri, a vdekje**

Në vitin 1993/1994, Redaksia filloi zhvillimin, që deri në atë periudhë nuk e kishte pasur asnjëherë. Fillon shpërndarja përmes rrjetit të rregullt zviceran (Kiosk AG dhe Naville), pastaj edhe atij gjerman. Kudo e ngado veprimtarët e LPK-së dhe veprimtarë tjerë të çështjes kombëtare, informonin redaksinë me zhvillimet në terren, por edhe e ndihmonin financiarisht. Me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Degës së LPK-së jashtë vendit, nga prilli 1993, del dy herë në muaj. Në fillim të vitit 1994, konsolidohet grupi i gazetarëve të Zërit të Kosovës në Prishtinë e Tiranë në përbërje: Nezir Myrtaj, Nuhi Paçarizi, Merxhan Abdylly dhe Besim Zymberi. Ndërsa në Tiranë angazhohet Shaban Sinani dhe Naim Zoto. Po në këtë vit dhe në vitin 1995, Zëri i Kosovës arriti kulmin edhe me abonime dhe shpërndarje. Kishte mbi 1.400 abonime dhe mbi 300 adresa të institucioneve dhe bibliotekave (sidomos bibliotekave në Shqipëri që ishin disa dhjetëra). Tashmë «Zëri i Kosovës» u bë pjesë zyrtare e pasurisë dhe fondit edhe të Bibliotekës Nacionale Zvicerane.

Gazeta „Zëri i Kosovës“ nr.3, 1 shkurt 1994, boton konto-numrin përmes të cilit anëtarët dhe simpatizantët e LPK-së, si dhe ata që dëshirojnë, mund të ndihmojnë të burgosurit, të ndjekurit nga pushtuesi dhe veprimtarinë e Lëvizjes Popullore të Kosovës, në drejtim të qëllimeve programore të saj, është ky:

**Schweiz Bankverein**  
**SBV ZH – Staufacher**  
**NC - 171.247.0 320**  
**VENDLINDJA THËRRET**  
**80 - 456 - 8**

Më 17 nëntor 1994, në Arau të Zvicrës - Pas një diskutimi të detajuar, Kryesia e LPK-së- Dega jashtë vendit, duke pasur parasysh vendimet e Mbledhjes së Katërtë të Përgjithshme në Prishtinë, edhe propozimet e Këshillave të Rretheve e Popullore të LPK-së në Kosovë, grupimeve ushtarake në terren, mori vendim që organizmi i ri ushtarak të quhet „Ushtria Çlirimtare e Kosovës“.

Kryesia merr vendim për fillimin e lëshimit të komunikatave, në të cilat merret përsipër autorësia e tyre. Komunikata u vendos të mbajë nr. 11. Në këtë Mbledhje merrnin pjesë: Fazli Veliu, Emrush Xehmajli, Gafurr Elshani, Ali Ahmeti dhe Xhavit Haliti.

Në vazhdimësi, në çdo numër do të boton konto-numrat e fondit „Vendlindja thërret“ për çdo shtet ku do të hapen, siç vijon:



<b>Fondi „Vendlindja thërret“</b>	
<b>NË ZVICËR:</b> Sewetz. Bankverein SBV ZH - Staufacher NC - 171.247.0 320 „VENDLINDJA THËRRET“ 80-456-8	<b>NË AUSTRI</b> Fondi „VENDLINDJA THËRRET“ OBERBANK BLZ 15080 Konto: 221055312
<b>NË GJERMANI:</b> DVAD e. V. Sparkasse Bonn, BLZ 38050000 Konto - Nr. 85431 (Dedikimi/Verwendungszweck): Spende für „VENDLINDJA THËRRET“	<b>NË NORVEGJI</b> Fond „VENDLINDJA THËRRET“ P.B 121 Grorud 0905 Oslo LANDSBANKEN AS Oslo, Norway Konto: 9001.64.87545
<b>NË SHBA:</b> Fondi: „VENDLINDJA THËRRET“ People's bank 328 Shippan av. 06902-6014 Konto: <b>000086 : 221172186 : 617008215</b>	<b>NË DANIMARKË</b> „VENDLINDJA THËRRET“ Den Danske Bank Reg.nr. 42 80 Konto nr. 42 80011355
<b>NË AUSTRALI:</b> Fondi: „VENDLINDJA THËRRET“ (HOME LAND CALLING) WESTPACK BANK Account No: 547089 Branch No: 733080 MELBOURNE VIC AUSTRALIA	<b>NË FRANCË</b> CREDIT LYONNAIS „VENDLINDJA THËRRET“ CL Lyon Terreaux (France) Code Banque 30002 Code Guichet 01045 Numéro de Compte: 0000079266Z; Clé RIB 25
	<b>NË SUEDI:</b> „VENDLINDJA THËRRET“ Sparbanken Sverige AB (publ) Kontonummer: 993.391.230-6 Clearringnummer: 8214-9

Gazeta „Zëri i Kosovës“, duke qenë një tribunë e hapur për tema të ndryshme, për letërsi, të cilën e ka pasur rregullisht në çdo numër, tanimë do të bëhet traditë përkujtimi i festës kombëtare, me një konkurs letrar, si formë më e qytetëruar e shprehjes së vetëdijes shqiptare në kushtet e hapjes së botës. Krahas rritjes, forcimit, dhe zhvillimit të strukturave të LPK-së dhe krijesës së saj-UÇK-së, rriteshin interesimet për të përcjellë gjithë aktivitetin ndaj Zërit të Kosovës.

Nga jashtë u shtua interesimin mbi zhvillimet dhe servimin e informatave, tanimë kur servuesi i parë për opinionin e gjerë, nën siglën e «**Telefaksi i Hapur**» ofroreshin Komunikatat e UÇK-së (që realisht i përpilonte dhe i lëshonte për opinion Kryesia e LPK-së). Tanimë, u bë njëra nga shtyllat kryesore të informimit të opinionit shqiptar dhe më gjerë, të një epoke vendimtare të zhvillimeve politike e ushtarake tek shqiptarët dhe zhvillimeve ballkanike e evropiane.

Që nga janari 1996, Zëri i Kosovës do të dalë një herë në javë, duke përmbushur një nga dëshirat e shumta të lexuesve. Ky ishte një obligim dhe domosdoshmëri e kohës që sa më parë, sa më drejt, realisht, objektivisht të informojë masën me shkrimet asnjane, pa censurë, objektive, reale, duke i thënë të zezës e zezë, të bardhës e bardhë.

Pra, duke qenë gjithmonë në shërbim të popullit si pjesë e pandashme shpirtërore. Është pritur me një kënaqësi të madhe dalja e javores „Zërit të Kosovës“, sepse në këtë gazetë shtroheshin qartë: -Ballafaqimi i të drejtës dhe i realitetit të çështjes sonë kombëtare.

Zëri i Kosovës, do të zbërthejë shumë mirë në mënyrë të dokumentuar me bashkëpunëtorët e vet të palodhur nga Shqipëria e Kosova, historinë e popullit shqiptar, kush kanë qenë dhe kush janë armiqtë dhe miqtë tanë. Zëri i Kosovës, në mënyrë reale dhe shumë objektive e sqaronte situatën për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhshmen.

Komunikata nr. 13, e ardhur në fax-in e redaksisë së „Zërit të Kosovës“ dhe e nënshkruar nga Shtabi Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përmes së cilës ata marrin përgjegjësinë për minimin e shtëpive të saponduarta për kolonët serbë nga Mali i Zi etj. Këtë Komunikatë do ta botojë Zëri i Kosovës, si vijon:



*Në fax-in e redaksisë sonë erdhi një Komunikatë e nënshkruar nga Shtabi Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përmes së cilës ata marrin përgjegjësinë e shpërthimeve të 11 shkurtit në disa lokalitete të kolonëve serb të ardhur nga Kraina dhe të vendosur në Kosovë.*

## **Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) merr përgjegjësinë për shpërthimet e 11 shkurtit '96**

Më datën 11 shkurt 1996, njësitet guerile të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndërmorën aksion të armatosur në zonën operative nr. 1. Aksionet u kryen me bomba dore në kampet e kolonëve serbë të ardhur nga Kraina, në kryeqytetin e Republikës së Kosovës Prishtinë, dhe në qytetet Mitrovicë, Pejë, Podujevë, Suharekë dhe Vushtri.

Okupatorëve nga Beogradi u bëjmë me dije se aksionet tona të dëritashme janë vetëm parajlamërimet e para. Në të mirë të paqës në Ballkan dhe interesin e popullit serb dhe shqiptar është që të ndërpritet kolonizimi i Kosovës; të ndërpritet terrori dhe shpërngulja mbi ne shqiptarët dhe okupimi i Kosovës. Menjëherë të fillojë dialogu për tërheqjen e trupave ushtarake nga Republika e Kosovës!

Ju bëjmë thirrje qendrave të vendosjes

ndërkombëtare e posaçërisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ta njohin pavarësinë e Kosovës për të cilën populli është deklaruar me referendum, në të kundërtën lufta në Kosovë është e pashmangshme. Vetëm duke respektuar vullnetin e popullit shqiptar do të mbetemi miq.

Ftojme përfaqësuesit e institucioneve shtetërore të Republikës, partitë dhe organizatat politike në Kosovë që t'i përmbahen vullnetit të popullit për pavarësinë e Kosovës. Kush e nënshkruan autonominë e Kosovës nën Serbi e pret fati i Esat Pashë Toptanit.

Ftojme mjetet e informimit shqiptar që të informojë drejt për aksionet tona çlirimtare dhe jo të merren me shabllone politike, përfundon Komunikata Nr. 18, e lëshuar më 14 shkurt '96 nga Prishtina, dhe e nënshkruar nga Shtabi Qendror i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Zëri i Kosovës, nr.8, shkurt 1996

Që nga viti 1990, Zëri i Kosovës ka informuar rregullisht mbi problematikën e shtypit në Shqipëri, do të vazhdojë praktikën, herë pas here do të botojë edhe artikuj të plotë, duke marrë paraprakisht edhe lejen e autorëve të tyre.

Kjo ishte si nevojë e një informimi objektiv dhe të paanshëm për periudhën e rrëmujshme politike në Shqipëri.

Më 29 qershor 1996, krahas aprovimit të raportit të redaksisë së „Zërit të Kosovës“, krahas vlerësimit të punës së bërë ndërmjet dy mbledhjeve në terren për sqarimin e masave të gjera kurbetqare për situatën e krijuar në Kosovë, u aprovua edhe kërkesa e kryeredaktorit **Beqir Beqa** për tu zëvendësuar me një tjetër, pas një kohe pune shumë voluminoze (5-së vite) të gjatë dhe vullnetare me anëtarë të tjerë të Redaksisë, Faik Rracin, Bislim Elshanin etj, po duke e vazhduar punën në „Zëri i Kosovës“, në cilësinë e anëtarit të Redaksisë.

Këshilli i Përgjithshëm, për punën e falënderoi në emër të të gjithë anëtarësisë së Degës së LPK-së dhe më gjerë. Ndërsa, Beqir Beqa falënderoi për mirëkuptimin dhe ndihmën që i është dhënë në kryerjen e detyrës. Këshilli i Përgjithshëm, Kryeredaktor zgjodhi prof. **Bislim Elshanin**, anëtar i deriatëhershëm i Redaksisë së „Zërit të Kosovës“.

Anëtarë të redaksisë: prof. Fazli Veliu, Ibish Neziri, Bedri Islami, Isuf Sherifi, Lulëzim Etemaj, Haki Morina, Bekim Krasniqi, Mustafë Krasniqi, Fatmirë Brajshori, Shukri Buja dhe Adnan Asllani. Krahas zgjerimit, rifillon edhe aktivizimi me shkrime dhe informata edhe sipas qendrave evropiane, Danimarka, Suedia e Norvegjia me Ibrahim Xhemajlin, Hajdin Abazin e Nufri Lekën, nga Brukseli i ofronte Këshilli i LPK-së, nga Franca, përmes Xhevat Bislimit dhe Këshillit të LPKsë në Paris, pastaj nga SHBA me Andon Kote dhe Ilir Zherkën, nga Sidney – Australia edhe nga Alaska etj. Stafit të redaksisë iu shtua në cilësinë e bashkëpunëtorëve aktivë, si: Mehmet Bislimi, Teuta Zymberi, Shukri Buja, Kadri Gërvalla, etj. Një kohë, më pak se një vit, ka lekturuar edhe Isuf Ismajli. Disa artikuj i ka paraqitur edhe Sali Kabashi 1993/ 1994.



*Objekti ku ka qenë redaksia e "Zërit të Kosovës" dhe Fondi Vendlindja thërret, Suchur, Aarau*

Sipas vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, secili Këshill ka pasur nga një të ngarkuar për të informuar Redaksinë për të gjitha aktivitetet politike e kombëtare, në kohë sa më të shkurtër.

Duke zgjeruar rrjetin e lexuesve të vet, filloi një shpërndarje në diasporë përmes kiosqeve, si dhe në Shqipëri. Ilegalisht në numër të kufizuar shpërndahet edhe në Kosovë. Gazeta „Zëri i Kosovës“ do t i shtojë faqet prej në . Kishte abonues rreth 1.000 në diasporë.

Konto e parapagimit, pasi kaloi Redaksia në Aarau, ishte:

**Aargaurische Kantonbank, CH-5001 Aarau, 16 113. 747.07 761,  
Konto: 50-6-9.**

Parapagimi bëhej edhe duke dërguar shumën e të hollave përmes letrës tek përgjegjësi për abonim-Avdi Muja, Delfterstr. 39, 5000 Aarau-CH.

Gazeta „Zëri i Kosovës“ kishte sektorin e librit, ku mund të bëheshin porositë për librin. Në fillim përgjegjës i këtij sektori ishte Habib Elshani, ndërsa më vonë, Mejdji Gega. Porosia mund të bëhej duke i dërguar të hollat dhe emrin e librave përmes postës, (pra përmes zarfit) në këtë adresë:

**Zëri i Kosovës, Postfach 233, 4104 Oberwil (BL)-CH**

Për lexuesit po japim edhe listën e titujve të librave dhe informacione të tjera.

1. Ushtria Çlirimtare e Kosovës-dokumente dhe artikuj	20.-Fr
2. Fjalor demokratik - Rexhep Qosja	30.-Fr
3. Afta e fuqit - Dritero Agolli - roman	20.-Fr
4. Shpirti i gllshërve - Dritero Agolli	12.-Fr
5. Sytë e Simonidas - Dhimitër S. Shuteriqi	12.-Fr
6. Pengu i moskuptimit - Shaban Sinani	13.-Fr
7. Kosova në udhëkryq '89 - Nikë Gjeloshi	18.-Fr
8. Trugjaker e Evropës - Koço Danaj	12.-Fr
9. 50-vjet histori e pajtuar - Koço Danaj	10.-Fr
10. Koha e demokracisë apo e shpëtitimit kombëtar - Koço Danaj	10.-Fr
11. «Shqipëria (jashitë «veritit» dhe «jugut»), Ibrahim Kelmendi	11.-Fr
12. «Ishim dhe mbetemi organizatë patriotike» Gafurr Elshani	5.-Fr
13. «Arif Seferi në shërbim të popullit»- monografi.A.D. e D.H.	8.-Fr
14. «Pas rrezes së diellit»-poezi, Avni Dehari	7.-Fr
15. «Rrjedhë autoktone»- poezi, Xhemal Rudi	7.-Fr
16. «Toka dardane» - poezi, Shaban Cakolli	7.-Fr
17. «Shpresa dhe zhgënjimes»- publicistike, Ramiz Alia	8.-Fr
18. «Kush janë shqiptarët»- vështrim, Fehmi Kelmendi	5.-Fr
19. «Sulltana»- monografi, Bepzad Begzadi	5.-Fr
20. «Cobanka»-poezi, Vehbi Furxhi	6.-Fr
21. «Gjurmë mali» - poezi, Remzi Salihu	7.-Fr
22. «Dielli për në Ballkan...»-poemë, Sadri Ahmeti	5.-Fr
23. «Ngjarjet masive kohë»- poezi, Vita Gashi	6.-Fr
24. «Puntoria kosovare»- intervista, Hajrullah Gorani	8.-Fr
25. «Të pa epur»- poezi, Hajdin Abazi	6.-Fr
26. «Ç'po ndryshon në raportet ...»- Arbër Kaqaniku	6.-Fr
27. «Shkrimtari»-roman, Mehmet Myftiu	12.-Fr
28. «Fati i thallit»-poezi, Mehmet Myftiu	8.-Fr
29. Arka e thallit Dritero Agolli-roman	20.-Fr
30. «Mos Qaj-Ne Pleure Pas»- poezi, Shemsi Makolli	8.-Fr
31. «Filozofia politike e çështjes shqiptare»-publicistike, U.Hoti	12.-Fr
32. «Millef i gjakosur»- poezi, Luar Maloku	6.-Fr
33. «Gjyq kundër PPSH- së», (poema satirike)	5.-Fr
34. «Sa pa na ngrënë vonces», (poezi), Lulëzim Etemaj	5.-Fr
35. «Vësirë të shthurur»-poezi, Kështjepë Hoxaj	8.-Fr
36. Balladë për tim atë dhe për vete, Dritero Agolli	12.-Fr
37. «Larg mes njerëzve»- kujtime, Liri Lubonja	8.-Fr
38. «Mëkati i uftësish»- poezi, Zhaklina Zadrina	6.-Fr
39. Meduza e dashuruar rriqatë syze dielli Moikom Zeqo	13.-Fr
40. «Lahuta e Malësisë, rikoruar për fëmijë, Odhise Grillo	8.-Fr
41. «Naim Frashëri», albim, Lirio Simo	5.-Fr
42. «Zë e mallnjerëzimi»- poezi, Fazli Veliu	5.-Fr
43. «Ndarjen nuk e nënshkruaj», poezi, Isuf Sherifi	5.-Fr
44. «Plaga e pashëruar» - Ali Alliu-Kelmendi	6.-Fr
45. «Punteon i lir»- Moikom Zeqo	12.-Fr
46. «Puthje me tmerr» - Poezi- Metush Zenuni	8.-Fr
<b>Libra të ilustruar për fëmijë</b>	
1. «Fluturimi mbi Sllupçan» - Nehas Somo	10.-Fr
2. «Sajti i turues»- Avni Dehari	6.-Fr
3. «Dielli»- Agim Vardari	6.-Fr
4. «Danja»- revistë për fëmijë	5.-Fr
5. «Tosta e eminit» - Rudina Prapollari	5.-Fr
6. «Përralla me qeros» - Natysha Xhungolli	5.-Fr
<b>Mënyra e postimit të librave</b>	
Porosia bëhet sipas listës së numrit të fundit të gazetës.	
Ajo bëhet me anë të zarfit duke i dërguar njëkohësisht edhe paratë e duhura në Frangë zveçeran ose NË KUNDËRVLERË, në adresën:	
Sektori i librit «Zëri i Kosovës»	Për informim më të hollësishëm
Postfach 4363	lajmërohuni te përgjegjësi i sektorit të
CH- 5001 Aarau	librit në tel:
	++41 (0) 79/669 49 23

Me kalimin e kohës, me zgjerimin e numrit të bashkëpunëtorëve në diasporë, në Kosovë dhe Shqipëri, do të bëhet edhe ngritja e nivelit profesional, analitik e informativ të punimeve publicistike të botuara në Zërin e Kosovës, duke rritur cilësinë e informimit të drejtë të lexuesve të vet, të cilët nuk mund të manipulohen me dezinformata e thashetheme.

Do të ndodhë në qendër të vëmendjes, jo vetëm të opinionit vendas, por edhe atij të huaj, sidomos pas ngjarjeve që e vunë Kosovën në epiqendër të interesimit të medieve dhe të diplomacisë ndërkombëtare.

Është fjala për ngjarjet në Drenicë e në gjithë Kosovën, me ç rast gazeta me informacione e pamje autentike të klasit të parë, duke ua bërë të qartë të gjithëve rrugën e vërtetë drejt lirisë dhe subjektin e vërtetë që e udhëheq këtë luftë, me qindra bashkatdhetarë, iu referuan Zërit të Kosovës, për të ndihmuar luftën çlirimtare në Kosovë.


Zëri i Kosovës, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së-Dega jashtë vendit, do të publikohet, edhe në internet, nga 30 prilli 1998, kur lexuesit mund t i lexonin materialet në faqet e internetit: **www.zik.com**, publikim që do të zgjojë

shumë interesim, jo vetëm te lexuesit, por edhe te shumë qytetarë të tjerë që nuk e kishin pasur më herët në duart e tyre gazetën „Zëri i Kosovës“. Zëri i Kosovës dhe më vonë edhe „Bota e re“, si dhe gazetarët e tyre, jo vetëm që u përballën me artilerinë e nacionalizmit serb, shtypin dhe radiotelevizionin e Beogradit; me shantazhe mesjetare, nëpërmjet teknikës më moderne të informimit-internetit, por dhe u kërcënuan se do ta shtypin e do ta zhdukin. Kërcënime të tilla, nuk do të mungonin, për fat të keq edhe nga disa individë dhe gazeta shqiptare!

Agjenturat serbe, duke parë ndikimin shumë të madh sqarues dhe mobilizues në luftën tonë çlirimtare të gazetës „Zërit të Kosovës“, në internet do ta sulmojnë faqen e tij më 6 tetor 1998, sulm ky që, do të zgjojë interesim të jashtëzakonshëm tek lexuesit e Zërit të Kosovës, me ç rast shprehin pezmin, indinjatën përmes telefonatave dhe letrave, si dhe gatishmërinë për ta përkrahur Redaksinë e „Zëri i Kosovës“, që punën e saj ta vazhdojë, duke sfiduar armiqtë e popullit tonë. Ky akt edhe tek shtypi dhe qendrat e ndryshme televizive, zgjoi interesim në Zvicër dhe jashtë saj.

Për ditë të tëra me radhë shtypi zviceran, televizionet dhe agjencia telegrafike shtetërore, SDA, kanë informuar lexuesit dhe shikuesit e tyre, lidhur më këtë akt të paskrupullt, të cilin do ta quajnë edhe sulm me prapavijë politike.

Sulmin do ta marrë organizata famëkeqe serbe, „Crna Ruka“ Dora e Zezë , e njohur për krime e gjenocid ndaj popullit shqiptar që nga viti 1911 e këndej. Në ueb-faqen e gazetës javore, në vend të shqiponjës dykrenore shqiptare, nxinte stema serbe. Pranë saj ishte shkruar në gjuhën serbe: „Kjo stemë do t u qëndrojë në flamurin tuaj deri sa të jeni gjallë“. Përveç kësaj, më tej, gjendet teksti shkruar në gjuhën serbe dhe angleze: „Mirë se vini në faqen e mashtruesve dhe vrasësve më të mëdhenj në botë“.



Ekspertët e informatikës në Zvicër, kanë arritur që ta diktojnë rrugën të cilën e kanë kaluar hakerët. Gjurma e të dhënave përmes shumë stacioneve përfundonte në një

kompjuter në Poloni. Hakeri ishte prezentuar si student jugosllav, dhe ka kërkuar nga punëtorët e Jehles (providerit në Aarau), ku ruhen të dhënat, ndërprerjen e menjëhershëm të editimit të „Zëri i Kosovës“ në internet.

Me ç rast ka kërcënuar se do të shkatërrojë kompjuterët e providerit, nëse nuk hiqet „Zëri i Kosovës“ nga rrjeti. Ky shantazhues do të jetë shumë i rrezikshëm edhe për Zvicrën, dhe për këtë, në marrëveshje me redaksinë, do të ndërpritet përkohësisht publikimi elektronik në internet, përderisa të instalohen pengesat plotësuese në hyrje të serverit.

Gazeta „Zëri i Kosovës“, në rrugën e saj që nga fillimi, referencë themelore pati popullin e robëruar shqiptar në viset e pushtuara. Burimin e çdo force për t i ndryshuar gjërat, ai gjithmonë e pa tek qëndresa popullore dhe jo tek konferencat e shtypit, tek faktorët e jashtëm dhe te konjunkturat politike të kohës. Ky parim, e udhëhoqi atë edhe në qëndrimin që mbajti rreth ngjarjeve në Shqipëri. Në raport me ngjarjet në Kosovë e Shqipëri, gazeta ka mbajtur qëndrim parimor, duke mos rënë në kurthet sektariste për t i mbajtur krahun njërit, ose tjetrit subjekt politik, por vetëm strategjisë së lirisë dhe të bashkimit kombëtar. Në këtë prizëm, ajo i ka parë edhe ngjarjet në Shqipëri. Pra, LPK si dhe organi i saj „Zëri i Kosovës“, ishte me popullin e Shqipërisë dhe jo me udhëheqësit e regjimeve të përkohshme. Edhe pse pas vitit 1990, në diasporë nisën të botoheshin një numër i madh i gazetave dhe revistave në gjuhën shqipe, prapë gazeta „Zëri i Kosovës“ vazhdoi të jetë edhe më tutje guximshëm, zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe i luftës së popullit të pushtuar shqiptar për liri. Gjatë luftës, mbështeti pa rezervë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Bëri një punë të madhe në afirmimin e UÇK-së dhe luftës së drejtë që bënte ajo për lirinë e Kosovës, i vetmi organ botoi guximshëm komunikatat e UÇK-së.


Shumica e këtyre gazetave dhe revistave të kësaj kohe, që botoheshin në perëndim (diasporë), nuk i botonin komunikatat dhe deklaratat e UÇK-së dhe as që e njoftonin lexuesin e tyre me luftën e drejtë që bënte UÇK-ja dhe populli shqiptar kundër pushtuesve serbë.



*Zëri i Kosovës nga numri i ardhshëm në pamjen si vijon:*



Në mars të vitit 1998, me vendimin e Kryesisë së LPK-së, Redaksia e Zërit të Kosovës boton librin dokumentar: Ushtria Çlirimtare e Kosovës , të autorit Gafurr Elshani, i cili libër u ribotua disa herë.



Në maj të vitin 1998, pas dorëheqjes së Kryeredaktorit të Zërit të Kosovës **Beslim Elshani**, Këshilli i Përgjithshëm i LPK-së, Dega jashtë vendit, do të caktojë kryeredaktor **Adnan Asllanin**. Po këtë vit, Redaksia e „Zërit të Kosovës“ bën marrëveshje me redaksinë e gazetës së studentëve „**Bota e Re**“ që drejtohej në atë kohë nga **Muhamet Mavraj**, që të dalin me të njëjtat materiale si „Zëri i Kosovës“, pra, që nga mesi i vitit 1997, botohet në Kosovë përmes faqeve të gazetës studentore „Bota e re“ që është shpërndarë legalisht nëpër kiosqe, duke shkuar edhe në frontin e luftës.

Gazeta „Zëri i Kosovës“ deri në qershor (14 qershor) 1999, del si organ i LPK-së.

Në këtë Adresë: **Zëri i Kosovës, Postfach 4363, CH-5001 Aarau,**

**Tel. Redaksia: 062/ 823 74 00, fax: 062 823 74 01, e-mail:**

**[redaksia@zik.com](mailto:redaksia@zik.com), Abonimet: 076 364 88 98, e-mail:**

**[abonime@zik.com](mailto:abonime@zik.com), Sektori i librit: 079/ 669 49 23**

**Xhironlogaria: Aargaurische Kantonbank / CH-5001 Aarau / 16  
113.747.07 761/, Konto: 50-6-9**

Më 22 maj 1999, në Bazel, në mungesë të kuorumit, përkundër 7 votave kundër dhe 6 pro të anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së Dega jashtë vendit për




të mos iu hequr „Zërit të Kosovës“ si organ i LPK-së, Zëri i Kosovës nga 14 qershori 1999, del si e përditshme informative shqiptare-Albanische Tageszeitung. Gazetë e LPK-së e jo, organ i saj. Selia e redaksisë do të kalojnë në këtë adresë:

**Zëri i Kosovës, Wehentalstrasse 299, CH-8046 Zürich, Tel. 01 370 19 63, Fax. 01 370 19 66 Vertrieb (shitje, shpërndarje): ASV-Vertrieb: GMBH, Süderstrasse 77, 20097 Hamburg, Tel. 040 347 240 11, Fax. 040 347 235 49**

Deri te nr. 45 (379) del si e përditshme informative shqiptare - Albanische Tageszeitung, gazetë e Lëvizjes Popullore të Kosovës. Pas formimit të Partisë së Bashkimit Demokratik, nga Nr. 46 (380), Zëri i Kosovës, del si e përditshme informative shqiptare-Albanisch Tageszeitung. Botues: **Partia e Bashkimit Demokratik.**

Bashkëpunëtor të përhershëm nga Kosova, që me guximin më të madh bashkëpunuan nën thundrën e policisë serbe, me „Zërin e Kosovës“ ishin: *Ibish Neziri, Merxhan Abdyl, Nuhi Paçarizi, Nezir Myrta, Ernest Luma, Ahmet Qeriqi, Besim Zymeri, Muhamet Mavraj, Fitnete Ramosaj, Isak Zymeri, Rrahim Sadiku, Faton Mehmetaj, Bajrush Behrami*, intelektualët: *Prof. Ukshin Hoti akademik-Rexhep Qosja, dr. Masar Stavileci, Prof.dr. Agim Vinca, Dritëro Agolli, Moikom Zeqo, Akademik-Bedri Dedja, publicisti-Viktor Çami, Xhevahir Spahiu, Dr. Refik Kucaj, Naim Zoto, Ramiz Kelmendi* etj. Pra, ishin reparte ushtarake e pena të dëshmuara dhe të guximshme si: *Shaban Sinani e Kadri Çenko, Koço Dane, Anton Kote e Bedri Islami, Lebit Murtishi, Fazli Veliu e Muhemet Kelmendi, Luan M. Rama e Shaban Braha, Ibrahim Kelmendi e Sabri Këçmari, Haxhi Zyba, Bislim Elshani, Arbër Ademi, Fitnete Ramosaj* etj. Me kontributin e të gjithë të përmendurve më lart dhe të anëtarëve dhe simpatizantëve të LPK-së, gazeta Zëri Kosovës bëri jetë dhe aktivitet vjeçar në mërgim.



**Dritëro Agolli**



**Rexhep Qosja**



**Ukshin Hoti**



**Shaban Sinani**

Në saje të mbijetesës së bashkëpunëtorëve në terren të luftës: Muhamet Mavraj, Nuhi Paçarizi, Ernest Luma, Lirije Mavraj, Driton Lajçi, Nuhi Bytyqi etj, do të mbijetojë edhe „Zëri i Kosovës“. Dhe s do të jetë asnjëherë zë i mekur, përderisa të jetë UÇK-ja, përderisa të jetë Lëvizja Popullore e Kosovës. Arsye tjetër për të mos u

mekur Zëri i Kosovës ishte se, qe Zëri i Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës dhe gjeneratave pasuese që nuk kursyen as jetën për lirinë e Kosovës. Porosia e Jusufit, Kadriut, Rexhep Malës, Afrim Zhitisë, Fadil Vatës, Adem Jasharit, Ismet Jasharit, Fehmi e Xhevë Lladrovci, e shumë të tjerëve, ishte që Zëri i Kosovës të jetë gjithmonë zë i fuqishëm dhe i pashterur i çlirimit të Kosovës, i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Zë që do ta nxjerrë në dritë vitalitetin e pashtershëm të Lëvizjes Popullore të Kosovës, në përkushtimin e saj sublim për lirinë dhe pavarësinë, për bashkimin e trojeve tona.

Pas 26 viteve të fillimit të botimit të gazetës në kushte të ilegalitetit në Kosovë, nga Kadri Osmani me shokë dhe 19 viteve të daljes së saj në kushte të mërgimit (Gjermani), nga militantët: Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka, gjaku i të cilëve qëndron në themelet e saj, do të kthehet në dhjetor 1999, me përkrahjen dhe bashkëpunimin e të gjithë atdhetarëve dhe intelektualëve shqiptarë, në rrethana të reja të pasluftës, në kushtet e lirisë në Kosovë, por dhe të shumë plagëve të trashëguara nga lufta: të pengjeve shqiptarë nëpër burgjet serbe, të pasojave të rënda sociale, të ndarjes së Mitrovicës, të plagëve të shqiptarëve në Kosovën Lindore (Preshevë, Bujanoc e Medvegjë), në Maqedoni dhe në Mal të Zi, tani në Kosovë do të vazhdojë të jetë një tribunë e hapur e mendimit shqiptar, që pa hezitim do të shqiptojë të vërtetën.

Më 20.09.1999, do të dalë numri i fundit në diasporë. Njoftimi i redaksisë do të jetë në të njëjtin numër të gazetës „Zërit të Kosovës“.

<p><b>ZËRI I KOSOVËS</b></p> <p>E përditshme informative shqiptare Albanische Tageszeitung</p> <p><b>Botues:</b> Partia e Bashkimit Demokratik</p> <p><b>Kryeredaktor:</b> Adnan Asllani</p> <p><b>e-mail:</b> redaksia@zik.com</p> <p><b>Internet:</b> http://www.zik.com</p> <p><b>Marketingu:</b> marketing@zik.com</p> <p><b>Vertrieb:</b> ASV - Vertriebs GmbH Süderstrasse 77 20097 Hamburg</p> <p><b>Tel:</b> 040 347 240 41 <b>Fax:</b> 040 347 235 49</p> <p><b>Druckerei:</b> SM Druckhaus Tel: 06103936138</p>	<p>hynë në stadiumin e qytetit i cili ishte tepër i vogël për t'i nxënë të gjithë ata njerëz që shprehnin dëshirën dhe admirimin e tyre për ta përcjellur manifestimin qendror. Kështu që brenda stadiumit kishin zënë vend rreth 50.000 qytetarë të</p> <p>të Pashtrikut Tahir Sinani.</p> <p>Që manifestimi të jetë vërtet madhështor, u kujdesën këngëtarët e artistët e mirënjohur nga trojet etnike shqiptare, siç janë Reshat Arbana, Mirush Kabashi, Ibrahim Tukiqi, Çun-Lajçi, Ilir Shaqiri, Aurela Gaçe,</p>
<h1>Njoftim i redaksisë</h1>	
<p><b>Të nderuar lexues,</b></p> <p>Meqenëse problemet teknike nuk po na lënë hapësirë të koordinimit dhe botimit të gazetës jashtë vendit, redaksia ka vendosur që përkohësisht të ndërpritet botimi i gazetës në Perëndim. Deri në krijimin e kushteve të botimit, për të cilën do të ju njoftojmë me kohë, „Zëri i Kosovës“ nuk do të jetë në duart tuaja. Jemi të bindur se nevoja që ju kenë për „Zërin e Kosovo-</p>	
<p>vës“ dhe ai për ju, është shumë e madhe, por deri në konsolidim të plotë do të na duhet të shkëputemi. Jemi të bindur se këto vështirësi tona do të tejkalohen shpejtë, kjo edhe nga fakti se redaksia është kthyer në Kosovë dhe do të dijë të zgjidhë pengesat e parqajitura.</p> <p>Kërkojmë mirëkuptim nga ju për këtë ndërpreje të përkohshme.</p> <p style="text-align: right;"><i>Redaksia</i></p>	

Zëri i Kosovës kthehet në Kosovë, po pa të parët e tij. Ata do të mbesin në tokën e huaj, në Undtergruppenbach të Gjermanisë, prandaj edhe kthimi i „Zërit të Kosovës“ ishte i pjesërishëm, që kjo do të mbetet gjatë në kujtesën shqiptare. Do të vazhdojë të jetë këmbëngulës në mbrojtjen e çështjes kombëtare, pra, do të jetë

zëri i mbrojtjes së aspiratave kombëtare, dhe do të japë kontributin e pakursyer në realizimin e pavarësisë së plotë kombëtare.

Gazetë, kjo që, për 19 vjet mbajti gjallë dhe përhapi idealin e lirisë kombëtare. Me këtë gazetë në gji, ranë shumë dëshmorë: Rexhep Mala e Nuhi Berisha, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu, u nisën në luftë shumë ushtarë dhe dëshmorë të UÇK-së, të cilët edhe mundësuan kthimin e saj pas 19 vitesh në Kosovë, në janarin e vitit 2000. Pas shumë ndjekjeve, kurtheve, burgosjes së gazetarëve dhe adhuruesve të shumtë të tij, goditjeve të rreshtuara nga pushtuesit serbo-malazezo-maqedonë, në njërën anë, dhe shërbëtorët e regjimit pushtues në Kosovë, pas kaq vite mbijetese: Ngadhënjeu atdhetarisht, moralisht, politikisht...

Zëri i Kosovës, ashtu si dhe Kosova, si gjithë shqiptarët, kishte realizuar deri më tani vetëm një pjesë të synimit të tij, pas luftës dhe sakrificave të bijve më të mirë të popullit shqiptar, të prirë nga UÇK dhe ndihmës së NATO-s, për të vazhduar në rrethana të tjera, plotësisht të reja, për të qenë vërtetë zë i Kosovës, zë i popullit shqiptar.

Qoftë për jetëgjatësi, qoftë për vijën e saj të qartë kombëtare e politike, u shqua gazeta „Zëri i Kosovës“, e cila ishte dhe mbeti, përçuesja më besnike e zërit të Adem Demaçit, Kosovës dhe e zërit të shqiptarëve të pushtuar.

Zëri i Kosovës, rifillon së botuarit në fund të dhjetorit 1999, pra më 30 dhjetor 1999, nr. (347), në Prishtinë, me përkushtimin e atyre që kishin mbajtur barrën, aspak të lehtë, të përgatitjes, botimit dhe shpërndarjes së saj, do të nisë botimi i gazetës më të dashur dhe atë në Kosovë, „Zëri i Kosovës“ si organi i LPK-së, me Drejtor: Gafurr Elshani, Kryeredaktor: Beqir Beqa, Redaksia: Fazli Veliu, Avdyl Kadolli, Nuhi Paçarizi, Nezir Myrtaj, Merxhan Abdyli, Faton Mehmetaj, Fitnete Ramosaj, Shaban Sinani, Faik Rraci etj.

**Adresa: Pallati i Shtypit, Kati VI, Prishtinë, Kosovë, tel. 549 016.**

# ZËRI I KOSOVËS

Viti i XVIII lbotimit, Nr.347

Cinimi: Kosovë 0.50 DM, Zvicër 2.5 Frs, Gjermani 2.5 DM

Redaktor: Jusuf Gërvalla, Drejtor i Lëvizjes Popullore e Kosovës

## "Zëri i Kosovës" në Kosovë

"Zëri i Kosovës" u kthye në atdhe, pas 18 vjetësh mërgimi në Evropë. Pë herë të parë u botua në Gjermani. Themelues i tij ishte atdhetari e veprimtari i shquar kombëtar Jusuf Gërvalla. Gjatë viteve në mërgim

"Zëri i Kosovës" u bë zëdhënës i Kosovës martire dhe i idealeve të Lëvizjes kombëtare të Kosovës. Djemtë kosovarë të përndjekur nga pushtuesi serb ishin bërë vetëdija më e zgjuar kombëtare, nga ilegaliteti i thellë dhe nga majat e qytetërimit evropian shilnin gërmimin Kosovë. Këtë idealizëm kombëtar e përhapnin edhe në Kosovë përmes organit të saj "Zëri i Kosovës". Ata djem idealistë ishin të përndjekur në Kosovë dhe në mërgatë nga dora kriminale serbe. Mirëpo, Lëvizja shqiptare ishte si ujë, që i duhet tokës dhe s'mund ta izolojë asgjë; ishte si dritë, si ajër, pa të cilat s'mundet jeta.

Pas shumë sakrificave sublime, mijëra vitesh burgje e internimesh, mijëra të vrarësh, të plagosurish e të torturuarish të shumë brezave dhe shkreterimit fashist serb, Lëvizja jonë kombëtare arriti cakun, sepse ajo ishte sublimin i



vullnetit dhe i shpirtit liridashës të popullit tonë, ishte rruga e lirisë që arriti kulmin me luftën heroike të UÇK-së. Ajo u goditi shumë herë, por nuk u mposhti kurrë, sepse nuk mund të mposhtej vullneti i një populli për liri.

"Zëri i Kosovës" do të vazhdojë të jetë një tribunë e hapur e mendimit shqiptar dhe pa hezitim do të shqiptojë të vërtetën, sado e hidhur qoftë ajo. Ai do të jetë këmbëngulës i mbrojtjes së çështjes kombëtare, pa hezituar se do të mbetet pakicë e mendimit shqiptar. "Zëri i Kosovës" do të japë kontributin e pakursyer në realizimin e pavarësisë së plotë kombëtare dhe në ndërtimin e shoqërisë së re demokratike. Ai do të jetë zëdhënës i interesave kombëtare, pavarësisht konjunkturave politike.

Shqiptarët po hyjnë në mijëvjeçarin e ri, pa e zgjidhur tërësisht çështjen kombëtare, me statusin ende të padeftuar të Kosovës, me barrën e rrezikimit të brezave anësorë të saj dhe me brenën e fatit të pengjeve, me fatin e shqiptarëve në Kosovën Lindore, në Maqedoni e në Mal të Zi.

Gazeta „Zëri i Kosovës“ do të vazhdojë, s’do të ndalet, sepse elementet e formulës së mbijetesës të Zërit të Kosovës ishin: Fryma kombëtare, përkushtimi ndaj saj deri në sakrificën më sublime të themeluesit Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka, Lëvizja Popullore, lufta çlirimtare e tri Ushtrive Çlirimtare, përpjekjet, gjaku dhe sakrificat e bijve më të mirë të Kosovës, për çlirim, bashkim dhe prosperitet gjithëkombëtar. Fjala e lirë shqipe, vullneti i popullit për liri, ishin shtyllat bazë në të cilat u mbështet dhe i mbështeti pa rezervë e hezitim, Zëri i Kosovës.

Gazeta „Zëri i Kosovës“ pati evolucionin e vet nga vetë evoluimi i Lëvizjes Çlirimtare. Ajo u përgatit e botua nga atdhetarët më të devotshëm shqiptarë në mërgim.

Zëri i Kosovës e ka mbaruar detyrën e vet, ngritjen e vetëdijes së masave dhe mobilizimin e tyre për luftën e vështirë çlirimtare, duke e shkruar korrespondentët popullorë nga gjiri i popullit, specialistë të profesioneve të ndryshme, që zotëronin zejen fisnike të shkrimit.

Shumë figura të shquara shqiptare publicistike, duke qenë shembull njerëzish të sakrificave për çështjen kombëtare, si që ishte rasti i simbolit të rezistencës Adem Demaçi, i cili e kishte më të shtrenjtë të vërtetën dhe të drejtën e popullit të vet se sa rininë dhe jetën në robëri dhe burgje.

Për orientimin e saktë, në momentet aktuale që kalonte vendi ynë, për qartësimin e mendjeve e njerëzve përmes artikujve, analizave dhe informacioneve që pasqyrohen në faqet e gazetës, për publikimin e krimeve sistematike të

planifikuar nga shteti serb dhe ai maqedon, që bëhej nën urdhra të qarta të zinxhirit komandues, madje edhe me urdhra të koduara në disa raste, fakte për këtë janë edhe zbardhja e dëshmimeve nga vetë pjesëmarrësit serb, në media serbe e gjetiu (2012/ 2013), redaksia e „Zërit të Kosovës“ do të marrë përgjegjësi, falënderime dhe urime më të mira nga bashkatdhetarët nga të gjitha vendet në Evropë dhe botë.

Në kuadër të redaksisë së „Zërit të Kosovës“ do të veprojë Biblioteka „Liria“, grupi që redakton botime të veçanta. Botimet e veçanta dhe sidomos organi „Zëri i Kosovës“ u bënë armë të forta propagandistike të kërkesës Kosova – Republikë, një tribunë ku masat e gjejnë veten, informohen, edukohen, mësohen si duhet kundërvënë armikut. Pra, „Zëri i Kosovës“ ishte armë e pazëvendësueshme në luftën e popullit shqiptar.

Biblioteka Liria Kolegijumi i Redaksisë së „Zëri i Kosovës“ do të botojë:

1. Në korrik të vitit 1984, dramën „Procesi“ të Jusuf Gërvallës, shkrimtarit të shquar, revolucionarit tonë të madh, i cili deri në momentin e fundit me fjalën e tij të zjarrtë e penën e tij të fuqishme, luftoi për lirinë e popullit shqiptar në Jugosllavi.
2. Në shtator të vitit 1984, në tërësi romanin „Gjarpijtë e gjakut“, të revolucionarit tonë, të parit romancier në Kosovë, Adem Demaçit. Pena e tij e fuqishme që në fillim preku plagën e madhe të popullit tonëvëllavrasjen....
3. Në nëntor 1984, një libër-xhepi „Qëndresa“, shkruar nga heroji, revolucionari Rexhep Mala. Është punim i parë i këtij lloji në Kosovë dhe në mërgim.
4. Në mars 1985, letrën e të burgosurve politikë në Burgun Qendror të Beogradit, për Kryesinë e RFSJ-së me titull: „Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion“.
5. Në qershor të viti 1985, librin me kujtime „PRANVERA E LULEVE TË KUQE“ të militantit- Nuhi Brisha, pas botimit të dramës „Procesi“ të Jusuf Gërvallës, romanit „Gjarpinjtë e gjakut“ të Adem Demaçit dhe librin me kujtime „Qëndresa“ të Rexhep Malajt.



6. Në korrik 1986, veprën e militantit, atdhetarit Kadri Zeka, me titull „Artikuj e Fjalime“. Në këtë vepër janë përfshirë artikujt që ky atdhetar i shquar shkroi në organin „Liria“, fjalimet që i ka lexuar në demonstratat e punëtorëve shqiptarë mërgimtarë në Perëndim.
7. Në korrik 1987, Programin e LPRK-së të aprovuar për herë të parë në Mbledhjen e Parë të Përgjithshme të LPRK-së. (Programi u botua, 1987, 88, 89 dhe në tetor 1991, në kuadër të materialeve të **Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme në Kosovë, dhe në vitin 2002, në Prishtinë.**)
8. Në tetor 1987, në kuadër të Bibliotekës „Liria“ të Kolegjiutit të Redaksisë së „Zërit të Kosovës“, u botua, në gjuhën gjermane, libri kushtuar Adem Demaçit me titull „Gjarpijtë e Gjakut“. Libri i botuar si manual-skriptë i dedikohet opinionit të huaj për ta njohur më mirë shkrimtarin dhe patriotin e shquar – simbolin e rezistencës kombëtare, i cili 25 vjet me radhë qëndron ballë për ballë me shovinistët serbomëdhenj, i pathyeshëm gjithmonë ngadhënjimtar. Në libër janë të përfshira: një parathënie e gjerë mbi jetën dhe veprimtarinë e Adem Demaçit; një fragment i gjatë i romanit më famë „Gjarpijtë e Gjakut“; fjala e Jusuf Gërvallës për Adem Demaçin; një parathënie shpjeguese për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, si dhe telegramin protestues që Shoqata e Shkrimtarëve të Suedisë ia dërgoi Kryesisë së RFSJ-së, në tetor 1987.
9. Në të njëjtin muaj dhe vit (1987), referati famëkeq i kryeshovinistit Vasa Çubriloviqit me titull: „Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re“, të cilin ai e lexoi për herë të parë në Beograd, më 3 nëntor të vitit 1944. Me botimin e këtij referati, u arrit qëllimi që të qesë para opinionit përparimtar edhe një platformë shoviniste, antipopullore, fashiste, raciste e thellësisht antishqiptare të serbomëdhenjve të kalibrit të Çubriloviqit e Millosheviqit me kompani. Qëllimi dhe porosia e këtij referati ishte shpërngulja me dhunë e popujve jo-sllavë dhe kolonizimi i tokave të tyre me serbo-malazez për të krijuar Serbinë e Madhe.
10. Në janar-shkurt 1988, Poemë alarmi e kushtrimi „**Këngë Nderi e Lirie**“, nga Ylli Flamuri. Poema është krijimtari e dalë nga trashëgimia e shëndoshë letrare, kulturore-historike; është njëherit pasqyrim e rikrijim artistik i thellë i luftës së popullit tonë për liri, ashtu si heronjtë „janë gjithmonë pasqyrim i një epoke të caktuar dhe bartës të tipareve më të qenësishme të shoqërisë“...
11. Në mars 1988, nxori nga shtypi broshurën për ekonomi, me titull „Ekspluatimi i egër nën prangat e rënda kolonialiste“. Kjo broshurë, e cila ishte botuar në vazhdimë në „Zërin e Kosovës“, ngërthen në vete një material të shtjelluar mbi baza shkencore dhe që ngërthen anën ekonomike të përmbledhjeve të ndryshme të cilat e kanë përfshirë

ekonominë jugosllave dhe me këtë edhe shtypjen e shfrytëzimin kolonialist të Kosovës.


12. Në qershor 1988, poema me titull:“ KOHË E NGJARJEVE TË MËDHA „ nga Alban Guri. Poema është një tablo e rrëfimeve tronditëse, por madhështore, për ngjarjet e bujshme të viteve 1910-1912, kur populli shqiptar i bashkuar, si një trup i vetëm, u ngrit në këmbë për të fituar pavarësinë dhe formuar shtetin shqiptar – fitore, që u arrit me shpalljen e Pavarësisë dhe ngritjen e Flamurit në Vlorë, më 1912.



13. Në mars 1989, KOSOVA RÖST (Zëri i Kosovës) numri parë, në gjuhën suedeze, në të cilën përfshihen materiale informuese për opinionin suedez lidhur me LPRK-së si organizatë demokratike e masave, gjendjen në Kosovë, kronologji e ngjarjeve të demonstratave të marsit 1989 në Kosovë, lista e të vrarëve prej 58 emrash gjatë vitit 1989, si dhe në kopertinën e pasme, botohet një hartë e RFSJ-së, me shpjegimet përkatëse skematike për popujt në këtë federatë.
14. Në mars 1989, LA KOSOVA („Kosova“) numri parë, në të cilën përfshihen materiale informuese lidhur me LPRK-në si organizatë demokratike e masave, kronologjia e demonstratave të marsit 1989, Raporti i Amnistisë Internacionale për Kosovën 1989, Peticioni i LPRKsë, dërguar Kongresit të 14-të të LKJ-së e materiale të tjera me interes për informimin e opinionit francez për gjendje në Kosovë.
15. Në prill 1989, botoi veprën e krijuesit bashkëkohor – revolucionar Hydajet Hyseni „Pushka amanet“. Titulli kuptimplotë i kësaj vepre në vargje shpreh vazhdimësinë e luftës së popullit tonë për liri.
16. Në shkurt 1990, „Kosova Republikë – kërkesë që lidhë në unitet të pandalshëm luftën e popullit tonë për çlirim nacional e social“, të Arbër Kaçaniku (Beqir Beqa). Ky libër është një studim shkencor mbi krizën e rëndë dhe problemet e konfliktet në Jugosllavi.
17. Në mars 1990, « Dielli » të autorit Agim Vardari (alias Avni Dehari), poemë. Kjo poemë ka shtatë pjesë me tituj të veçantë, që përbëjnë tërësinë e poemës. Në spikamë ka një polic shovinist (Miqon), i cili i

verbuar nga kërkesa gjithëpopullore e shqiptarëve, një ditë e burgosë edhe një top futbolla, mbi të cilin fëmijët e kishin shkruar parullën « Kosova Republikë »...

18. Në tetor 1990, Kolegjiumi i Redaksisë së « Zërit të Kosovës », botoi në 10.000 ekzemplarë, veprën e simbolit të rezistencës sonë kombëtare, Adem Demaçit me titull « **Republika e Kosovës është shpallur në zemrën e popullit tim** ». Punën për botimin e intervistave të Adem Demaçit Redaksia e « Zërit të Kosovës », e filloi në kohën kur Adem Demaçi vuante dënimin në burgun e Stara Gradishkës. Në botimin e parë, qershor 1989, me të njëjtin titull, u përfshinë dy intervista, njëra dhënë « Borbës » tjetra « Mlladinës », ndërsa në botimin e dytë, pos dy të parave, 11 intervista dhe apelime drejtuar opinionit demokratik botëror, më 24 gusht 1990.
19. Në tetor 1990, në shtypshkronjën e Shoqatës Kulturore të Shqiptarëve të Kosovës « Pjetër Bogdani » në Biel, Kolegjiumi i Redaksisë së « Zërit të Kosovës », në tirazh prej 3.000 copash, botoi veprën e dytë të Arbër Kaçanikut (alias Beqir Beqa) « Ç’po ndryshon në raportet Lindje – Perëndim »...



20. Në tetor 1990, novelën e Ismail Kadaresë „Krushqit janë të ngrirë“. Kjo novelë në sfondin e vet ka demonstratat e vitit 1981, në të cilat studentët, punëtorët, fshatarët, mbarë populli ynë rrugëve të Prishtinës dhe të qyteteve të tjera të Kosovës me guxim kërkoi liri, barazi, republikë....
21. Në dhjetor 1990, përmbledhjen e Këngëve historike të prof. Fehmi Kelmendit nga Presheva...
22. Në janar 1992, ribotoi Programin dhe Statutin e LPRK-së të përmbledhur në një broshurë të veçantë, e cila do t ju shpërndahet anëtarëve dhe simpatizantëve të LPRK-së dhe të tjerëve.
23. Në mars 1985, botoi përmbledhjen „Zë e mall mërgimi“ të Fazli Veliut. Në këtë përmbledhje, sikur një fije jete, valëzon optimizmi i pathyeshëm dhe besimi i paluhatshëm në fitoren, besim ky i cili mbahet lart si




flamur shprese dhe si forcë shtytëse për të qëndruar, për të vepruar, për të jetuar... Vetë përmbledhja poetike „Zë e mall mërgimi“ është, në të vërtetë, një lloj thirrje kushtrimtare e autorit për liri, thotë e shkruan Hajdin Abazi.

24. Në korrik 1995, shtëpia botuese „Zëri i Kosovës“ botoi librin vjet histori e pahumbur të Koço Danajt. Ky libër është në vazhden e dy të parëve, por edhe shënon një nivel më të lartë e më kompetent shkencor-politik, thotë Bislim Elshani.





25. Në shtator 1985, u botua libri „Filozofia politike e çështjes shqiptare“, përmbledhje studimesh dhe kumtesash të Mr. Ukshin Hotit. Libri u përgatit nga shtëpia botuese „Rozafa“ në Tiranë, në bashkëpunim me shtëpinë botuese „Zëri i Kosovës“, nën kujdesin e Bislim Elshanit
26. Në maj 1996, Redaksia e „Zërit të Kosovës“ botoi librin „Realiteti dhe perspektiva e çështjes kombëtare“ të mr. Muhamet Kelmedit.
27. Në Qershor 1987, Redaksia e „Zërit të Kosovës“ botoi librin e Ibrahim Kelmendit „Shqipëria jashtë veriut dhe jugut“. Autori kishte fatin të ishte në qendër të ngjarjeve. Ai do të shkruaj Libri një ditar të ngjarjeve të fillim marsit 1987 në Shqipëri...



Në mars të vitit 1998, me vendimin e Kryesisë së LPK-së, Redaksia e „Zërit të Kosovës“ boton librin dokumentar: Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të autorit Gafurr Elshani, i cili libër u ribotua disa herë. Pas luftës së lavdishme të UÇK-së dhe çlirimit të Kosovës, për LPK-në dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për heronjtë e Kosovës dhe heronjtë kombëtarë dhe për luftëtarët e lirisë e bashkimit kombëtar, do të shkruajnë dy udhëheqësit e LPK-së në periudha të caktuara;

Fazli Veliu, kryetar shumëvjeçar i LPK-së, poet dhe studiues, do të shkruaj dhe botojë librin „LPK DHE UÇK: Një emblemë, një qëllim“. Shumica e shkrimeve kronologjike i takojnë kohës së luftës, është njëfarë mënyre, vazhdim i luftës pas përfundimit të luftës, është mirënjohje për shokët e rënë në betejë, përmendorja e parë për të rënë, nderim për historinë, siç shprehet publicisti i mirënjohur, Shaban Sinani.

Berdi Islami, kryetar i LPK-së nga gjysmëviti 1998 deri në përfundim të luftës, gazetar, publicist, do të shkruaj dhe botojë librin „Përjetësi e dyfishtë“, libër i cili do të vlerësohet nga Adem Gashi, shkrimtar si vijon: *...Në këtë vazhdë unë shoh edhe depërtimin e autorit në pjesët e padukshme të shtjellës së ngjarjeve dhe në strukturën e brendshme shpirtërore e mendimtare të personazheve të tij. Ç'them dhe unë, të personazheve të tij!? Po ata janë shokët, miqtë, vëllezërit, prindërit, bashkëveprimtarët, me një fjalë gjindja e tij. Duke shkruar për ta, ma thotë mendja, ai ndërton harkun e gjallimit të tij, i cili prish kufirin ndërmjet atij dhe këtij, ndërmjet autorit që rrëfen dhe narratorit që vetërrëfëhet.*



Rubrikat: Komenti, Këngët e lirisë, letrat nga burgu, letrat e lexuesve, intervista, vështrime, kulturë-art-letërsi, fejonistikë, letra-reagime-njoftime, aktualitet, trajtesa, kronika, korrespondenca popullore dhe shtypi botëror për Kosovën.

Gazeta „Zëri i Kosovës“ do të botojë në faqet e tij, dorëshkrimet e pabotuara të Rexhep Malës, Kadri Zekës, Nuhi Berishës, Bajram Bahtirit etj, artikujt shkencorë të historianit dhe atdhetarit dr. Refik Kucaj, dr. Ali Hadrit, prof. Stefanaq Pollos, akademik Rexhep Qosjes, Aleks Budës, poetit Dritëro Agollit, shkrimtarit Ismail Kadare, Ramiz Kelmendit, dr. Shaban Sinanit, Dr. Moikon Zeqo, Kadri Çenko, Agim Vincës, fjalimet e mbajtura të Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë për Kosovën, elaboratet dhe memorandumet e Akademisë Serbe –Platformën shoviniste mbi Kosovën, që zbulon me qartësi edhe synimin mbi zhdukjen e popullit tonë të lashtë e heroik, shkrime dhe artikuj të gazetave shqiptare e veçanërisht „Zëri i Popullit“, Tiranë.

**Adem Demaçi** i cili kaloi rininë dhe jetën nëpër burgjet fashiste jugosllave, i ndrydhur pas hekurave si i burgosur i ndërgjegjes kombëtare., anëtarët e lëvizjes

në vitet 60-të e pastaj. Zëri i Kosovës dhe LPK, në gjithë Evropën e më gjerë mbajtën flakën e lirisë të ndezur për brezat që luftuan dhe fituan lirinë.

## **Lavdi!**

### ***Vlerësim:***

*Gjatë gjithë kohës që u themeluan, mbushën me shkrime, shpërndanë: Zëri i Kosovës, Lajmëtari i lirisë, Liria etj., veprimtarët, të burgosurit, mërgimtarët, në punimet e prezantuara, faqet e shtypit, plasuan edhe punimet e artit, pikturat, vizatimet etj., të cilat, njëkohësisht, shfaqnin brendinë e punimeve dhe fuqizimin e tyre. Disa nga këta, kanë rënë disa mbijetojnë. Kemi pasur mundësinë që t'i përcjellim dhe t'i urojmë për punën e tyre të pandalshme. Ndër ata, Emrush Xhemajli, pasqyroi jetën e të burgosurve dhe figurat e ndritshme të Lëvizjes sonë, si: Kadri Zekën, Rexhep Malën, Luan Haradinajn, Xhevë e Fehmi Lladrovcin, Beqir Limanin etj. Krahas tij, me përkushtim, qëndron Muhamer Shabani, që na prezenton figurat e ndritshme, në periudha të ndryshme, shumë vendimtare: Të Mbledhjes së Parë të Përgjithshme të Lëvizjes Popullore të Kosovës; të lavdishmit: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Bajram Bahtiri etj. Këta dhe shumë të tjerë, punimet e tyre i kanë shfaqur edhe në ekspozita ndërkombëtare, të cilat janë vlerësuar, si më të përsosurat, sa i takon revolucionit, luftës për liri, ardhmërisë, njerëzimit.*

Përveç redaktorëve, anëtarëve të redaksisë të Zërit të Kosovës, që bënë punë të mundimshme e vullnetare, anëtarëve të LPK-së, simpatizantëve, do t'i falënderoja dhe gjithë veprimtarët si: **Gafurr Elshanin**, Përgjegjës Financiar i LPK-së, Dega jashtë vendit, **Sylë Nuhën**, që jetonte dhe vepronte në Dyseldorf të Gjermanisë, njëri ndër militantët e hershëm të Lëvizjes, qysh nga vitet `70-ta, ishte bashkëveprimtar i figurave më eminente të Lëvizjes, që dha një kontribut moral e material, me mijëra DM për dalje të rregullt të gazetës Zëri i Kosovës dhe në mbështetje të veprimeve luftarake të UÇK-së dhe **Afrim Zeqirin**, që jeton dhe punon në Gjermani i cili dha mira DM, **Rrahman Maliqin**, që jetonte dhe punonte në Bazeli etj.

Në vazhdim, Zejnel Iljazi nga Tetova, emigrant në Dyseldorf; Tefik Bexheti nga Zajazi i Kërçovës, me punë, po ashtu në Dyseldorf, djali i tij Bashkimi – Kurtish Bexheti, që drejtonte punimet e veprimtarëve ilegal te Kadri Zeka...

**Falënderim:** Familjeve brenda dhe jashtë vendit që strehuan dhe ndihmuan anëtarët e Redaksisë dhe të çështjes sonë, në kohë të vështira, kur armiqtë dhe bashkëpunëtorët e tyre ishin në kulmin e fushatës antishqiptare.

## KRYEREDAKTORËT E GAZETËS „ZËRI I KOSOVËS“



*Kadri Osmani-Mani*



*Jusuf Gërvalla*



*Xhafer M. Durmishi*



*Xhafer Shatri*



*Mustafë Xhemajli*



*Avni Dehari*



*Beqir Beqa*



*Bislim Elshani*



*Adnan Asllani*

# ZËRI I KOSOVËS

VITI XV | BOTIMIT • NR. 413, 4 PRILL 2002 • ÇMIMI: 0.50 EUR

ORGAN I LËVIZJES POPULLORE TË KOSOVËS

**Intervistë me deputetin e LPK-së në Parlamentin e Kosovës, z. Bedrush Çollaku**

## **MBLEDHJA E FUNDIT E KUVENDIT MË TEPËR I PËRNGJANTE KUVENDIT TË KOHËS SË RRAHMAN MORINËS SESA NJË KUVENDI QË KA DALË PREJ ZGJEDHJEVE TË LIRA**

**N**uk janë injoruar vetëm invalidët dhe veteranët e luftës, por është injoruar tërë lufta, është injoruar vetë UÇK-ja, e cila në fund të fundit e sollti këtë ditë, e mundësoi që ne të ulemi në këtë Kuvend. Dhe, kërkesa e tyre ishte krejt e natyrshme. Ata po kërkonin që të mos i jepej besimi për president të Kosovës një njeriu që koketonte me Milosheviqin në kohën kur këta djem e vajza po përballeshin me makinërinë e tij ushtarake, një njeriu që edhe sot e kësaj dite mohan luftën e UÇK-së. Ndoshta do të mund t'i kaptoja deputetët e LDK-së për injorimin e kësaj kërkesë, por asesi nuk mund t'i kaptoj ata të PDK-së, të cilët në fund të fundit thirren në vlerat e kësaj lufte, nuk janë injoruar vetëm invalidët dhe veteranët e luftës, por është injoruar tërë lufta, është injoruar vetë UÇK-ja, e cila në fund të fundit e sollti këtë ditë, e mundësoi që ne të ulemi në këtë Kuvend. Dhe, kërkesa e tyre ishte krejt e natyrshme. Ata po kërkonin që të mos i jepej besimi



për president të Kosovës një njeriu që koketonte me Milosheviqin në kohën kur këta djem e vajza po përballeshin me makinërinë e tij ushtarake, një njeriu që edhe sot e kësaj dite mohan luftën e UÇK-së. Ndoshta do të mund t'i kaptoja deputetët e LDK-së për injorimin e kësaj

kërkesë, por asesi nuk mund t'i kaptoj ata të PDK-së, të cilët në fund të fundit thirren në vlerat e kësaj lufte, nuk janë injoruar vetëm invalidët dhe veteranët e luftës, por është injoruar tërë lufta, është injoruar vetë UÇK-ja, e cila në fund të fundit e sollti këtë ditë, e mundësoi që ne të ulemi në këtë Kuvend. Dhe, kërkesa e tyre ishte krejt e natyrshme. Ata po kërkonin që të mos i jepej besimi për president të Kosovës një njeriu që koketonte me Milosheviqin në kohën kur këta djem e vajza po përballeshin me makinërinë e tij ushtarake, një njeriu që edhe sot e kësaj dite mohan luftën e UÇK-së. Ndoshta do të mund t'i kaptoja deputetët e LDK-së për injorimin e kësaj

**RATIFIKIMI I MARRËVESHJES BEOGRAD-SHKUP PËR KUFIRIN ME KOSOVËN**



## **LËGJITIMIMI NDËRKOMBËTAR I CENIMIT TË KUFIRIT TË KOSOVËS**

**SI NË KOHËT MË TË LIGA SHQIP-TARËT PO E PAGUAJNË HARAQIN E POLITIKAVE ANTISHQIPTARE NË BALLKAN**

**Në qershor mbahet Mbledhja e Gjashtë e Përgjithshme e LPK-së**

### **A MUND TË LUFTOHET KRIMI ME NJË RREGULLORE?**



*Në opinion d o m i n o n mendimi se pa ndihmën e ndërkombëtarëve nuk ka mundur të ketë krim të përmasave*

të tilla, sepse ata i kanë në duart e tyre policinë, ushtrinë, gjyqësinë, të gjitha kompetencat... dhe nuk mund të kërkohet përgjegjësi jashtë këtij rrethi. Peshqit e mëdhenj duhet të kërkohen pikërisht brenda këtij rrethi

### **ZHVILLIMET POLITIKE NË SHQIPËRI A do të zgjidhet problemi aktual brenda gardhit?**

**S**hpesh ne shqiptarët, për hir të mungesës së përvojës, apo për arsye të manipulimeve zgjedhore, nuk ia kemi qëlluar që me votën tonë të zgjedhim më të mirin, atë që përbën realisht elitën tonë. Më duket se votuesi shqiptar, udhëhiqet nga një koncept jo i drejtë për të zgjedhurit e tij; ai, më duket, shkon drejt kutisë së votimit, për të votuar kundër dikujt, e jo pro dikujt. Ideja se "unë do të shkoj të votoj kundër këtij, apo atij politikani", është koncept kolektiv regresiv. Është mirë të mos rendet më pas këtij koncepti.

### **"Uzurpatorët" e rrugëve të Kosovës**



## Biografia dhe veprimtaria e autorit

**Sejdi Gega**, i lindur në fshatin Gurrë, ish Studençan, K.K. Therandë, ish Suharekë, më 16 prill 1955, në një familje mesatare bujqësore, babai- Sadik Hajdar Gega (01.10.1930) dhe Gjylferije Kovaçi – Gega (23.02.1928 lindur në Samdraxhë të Therandës).

Fëmijërinë dhe rininë e kaloi në mjedis familjar, me tre vëllezër dhe katër motra. Sejdiu është fëmija i dytë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje me sukses të shkëlqyeshëm, ndërsa të mesme-Gjimnazin e shkencave natyrore e kreu në Therandë, në vitin 1975.

Studimet i kreu në Universitetin e Prishtinës, drejtimin e Teknologjisë së Përgjithshme, në Fakultetin Xehtarë - Metarlugjik, në Mitrovicë.

Në vitin 1979/1980, filloi të punojë si profesor i shkencave natyrore në Gjimnazin (QAMO)-„Jeta e Re“ në Therandë.

Në maj 1981, është arrestuar nga organet e sigurimit shtetëror jugosllav për veprimtari „armiqësore“ dhe është dënuar më 6 gusht 1981, me 6 vite burg nga Gjykata e Qarkut në Prizren, nën kryesimin e trupit gjykues nga Orhan Rekathati, sipas paragrafit 1, lidhur me nenin 114, të LP të RFS-ës, në grup me Afrim, Hazirin, Halil Morinën dhe me Prof. Bislim Elshanin.

Më 8 prill 1981, me një grup shokësh do t i transferojnë në Pejë dhe nga Peja së bashku me një grup tjetër do t i dërgojnë në Kroaci, nën përcjellje të rreptë policore në Burgun Qendror të Zagrebit, mandej në Gospiq dhe në Lepogllavë, ndërsa në prill 1983 transferohet në Stara Gradishkë, në burgun më famëkeq ku vuante dënimin Adem Demaçi.

Sejdi Gega, anëtar i LPK-së, kryetar i Këshillit të Rrethit të Therandës nga viti 1989. Pjesëmarrës në Konferencën e Dytë të Jashtëzakonshme të OMLK-së (4 shkurt 1991 në Prapashticë), së bashku me Shefki Muçën dhe Ilaza Kadollin nga Theranda.

Njeri nga Ata, Sejdi Gega na doli i pagjunjësuar nga burgjet dhe iu bashkëngjit veprimtarisë sonë në mërgim: Ishte shëndetlig, i dërrmuar por i gatshëm për të marrë detyrë në kuadër të Lëvizjes sonë, të cilën, ne të mërguarit, e bartnim si trashëgim – thesar, nga i burgosuri i dekadave- Adem Demaçi, nga korifenjtë e Lëvizjes: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla e shumë të tjerë, të rënë e në këmbë...

Ai, në mesin tonë vinte me kujtimet e pashlyeshme për të burgosurit. Për ata, ai fliste me adhurim dhe besim, duke na sjellë edhe portretet e tyre, të krijuara në burgjet e hekurta jugosllave. Kur hyri në mesin tonë, kërkoi t i caktonim detyra më të vështira dhe më të rëndësishme. Nga shtator/tetori i viti 1991 do të kalojë jetë ilegale deri në fillim të janarit 1992, kur detyrohet të lëshojë Kosovën.

Nga janari i vitit 1992 do të bëjë jetë mërgimtari në Zvicër. Tri vitet e para do të punojë mësues, në mësimin plotësues me nxënësit shqiptarë në Kanton Uri.

Anëtar aktiv i LPK-së, Dega jashtë vendit, anëtar i Këshillit të Përgjithshëm deri në mbarim të luftës, anëtar i Kryesisë së Nëndegës së LPK-së për Zvicër, me përgjegjësin e arkëtarit. Nga korriku i vitit 1998, anëtar i Kryesisë së LPK-së, me përgjegjësinë e Përgjegjësit Financiar për Degën e LPK-së jashtë vendit.

Sejdi Gega, personalisht dhe me anëtarët e familjes së tij të ngushtë, si dhe me veprimtarët e përkushtimit të Madh Kombëtar, krijoi kushte veprimtarie, të cilat ishin në vazhden e pararendësve të betuar në Atdhe, Komb, Flamur.

Një kujdes të veçantë, dëshmoi ndaj kryepersonazhit të lëvizjes Adem Demaçi, bashkëveprimtarit të këtij Ahmet Haxhiu, drejtpërdrejt ndaj Fadil Vatës, Ukshin Hotit, Beadin Hallaçit etj. Aktualisht është në lidhje të ngushtë me frymëzuesin kryesor të të gjitha gjeneratave- Adem Demën dhe familjen e tij të ngushtë.

(Veprimtaria e tij vazhdon në mërgim, e cila përfshihet në fillim të këtij libri).



*Pllaka përkujtimore (unike), në emër të SHVL-UÇK-së, kushtuar Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës në anën e Kërçovës*



